



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije
Ministry of Education Science & Technology

KORNIZA KURRIKULARE

e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës

(e rishikuar)

Prishtinë, gusht 2016

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Këshilli redaktues:

Kabineti i Ministrit, MASHT

Departamenti për zhvillimin e arsimit parauniversitar, MASHT

Divizionit për planprograme dhe tekste shkollore, MASHT

Redaktor gjuhësor:

Sabit Jaha

Radhitja:

Gëzim Duzha

Ballina:

Gëzim Duzha

Shtypshkronja:

"BLENDI"

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS / GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË / MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTOR I ARKIVIT / ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica	013
Org. Udh. Org. Udh.	
Nr. i faqeve Br. stranica	2
No. pages	
Nr. Prot. Br. Prot.	4783
Print No.	
Dates	
Datum	27.10.2016
Date	
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministririt / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 25 tetor 2016

Ref. Nr: 231/01 B

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të rregullorës nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave (Gazeta Zyrtare, Nr. 1,18 prill 2001), nenit 5 dhe 24 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, merr këtë:

V E N D I M


1. APROVOHET rishikimi i Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, sipas vendimit nr. ref. 51/01B të datës 10 mars 2016, për rishikimin dhe finalizimin e dokumenteve kurrikulare.
2. Obligohet Departamenti për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar dhe të gjitha Divizionet e MASHT-it që janë të përfshira në këtë proces duhet t'i kontribuojnë zbatimit të kurrikulës së re.
3. Të gjitha Drejtoritë Komunale për Arsim dhe të gjitha shkollat e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës i fillojnë përgatitjet për fillimin e zbatimit të kurrikulës së re. Përgatitjet duhet të përfshijnë:
 - 3.1. Informimin dhe sensibilizimin e komunitetit arsimor të shkollës me kurrikulën e re;
 - 3.2. Riorganizimin e organeve profesionale të shkollës;
 - 3.3. Përcaktimin e mësimeve që do të punojnë në klasat ku fillon zbatimi i kurrikulës së re;

- 3.4. Përgatitjen e planeve specifike për përmbushjen e detyrimeve dhe autonomisë së shkollës në zbatimin e kurrikulës së re.
4. Shfuqizohet vendimi Nr.262/01B i dt.29.08.2011.
5. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë dhe pas realizimit dhe zbatimit të vendimit nr. ref. 51/0B të datës 10 mars 2016, për rishikimin dhe finalizimin e dokumenteve, i cili proces ka qenë rezultat i analizës dhe vlerësimit të zbatimit të kurrikulës nga koordinorët e MASHT-it për kurrikula, nga inspektorët e arsimit, nga koordinorët e DKA-ve për kurrikula, nga koordinorët e shkollave, nga prindërit, nga trajnerët, nga bashkëpunimi me Institutin e Zhvillimit të Arsimit të Republikës së Shqipërisë, nga Projekti i Binjakëzimit, nga projekti i mbështetur nga GIZ, nga projekti BEP i mbështetur nga USAID dhe partnerë të tjerë zhvillimor, nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, nga vizitat e bëra në shkollat pilotuese, raportit të propozimeve për ndryshime kurrikulare, si dhe raportit mbi procesin e rishikimit dhe finalizimit të dokumenteve kurrikulare, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. dr. Arsim BAJRAMI, ministër



Iu dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm, MASHT;
- Departamentit për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar, MASHT;
- Departamentit për Politikat e Arsimit Parauniversitar, MASHT;
- Departamentit të Inspektimit të Arsimit, MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Arsimin Parauniversitar, MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve, MASHT;
- Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve, MASHT;
- Divizionit për Planprograme dhe Tekste Shkollore, MASHT;
- Institutit Pedagogjik të Kosovës;
- Të gjitha Drejtorive Komunale për Arsim;
- Arkivit, MASHT.

Fjala e Ministrit

Nxënës, mësimdhënës, udhëheqës të arsimit, prindër dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kam kënaqësinë që, në emër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, të paraqes Kornizën Kurrikulare për arsimin parauniversitar. Ky dokument është rezultat i punës së përkushtuar të ekspertëve të arsimit, vendor e ndërkombëtar. Njëherit, ky dokument ka rol qenësor në promovimin e vizionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për mësimin gjatë gjithë jetës, avancimin e cilësisë në arsim dhe krijimin e një sistemi arsimor të qëndrueshëm dhe në trend me zhvillimet e kërkesat e kohës.

Ky verzion i rishikuar i Kornizës Kurrikulare reflekton përvojat nga shkollat pilotuese, shqetësimet dhe sfidat e ngritura gjatë zbatimit praktik, vlerësimet e jashtme dhe rekomandimet e ekspertëve të ndryshëm vendor e ndërkombëtar. Gjithashtu, në këtë Kornizë janë shfrytëzuar të dhënat e hulumtimeve dhe të praktikave të mira ndërkombëtare në fushën e arsimit dhe të nxënies. Korniza Kurrikulare e rishikuar e mbështet synimin fillestar që zhvillimi i kompetencave të udhëheqë procesin e zhvillimit të sistemit të kurrikulës dhe të përvojave të mësimdhënies dhe nxënies. Udhëzimet e ofruara në këtë dokument ofrojnë mundësi që nxënësit kosovar të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshtarët e tyre në Evropë e më gjerë.

Përdorimi dhe zbatimi me sukses i Kornizës Kurrikulare do të mundëson kalimin nga Kurrikula e bazuar në përmbajtje lëndore në një Kurrikul që promovon dhe mbështetë zhvillimin e kompetencave. Kjo Kurrikul ndihmon nxënësit, të rinjët dhe të rejtat, të eksplorojnë dhe kuptojnë botën rreth tyre, të ndërlidhin përvojat e tyre të të nxënies me jetën e vërtetë dhe zhvillojnë kompetenca në nivel të lartë dhe në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.

Rishikimi i Kornizës Kurrikulare u bazua në përvojat nga pilotimi i saj në 95 shkolla të vendit. Me këtë rast dëshiroj të falënderoj drejtorët dhe mësimdhënësit e këtyre shkollave, Drejtoritë Komunale të Arsimit, zyrtarët e MASHT dhe të gjithë ekspertët e përfshirë në rishikim dhe finalizim të këtij dokumenti bazë për zhvillimin dhe avancimin e arsimit në Kosovë.

MASHT vlerëson lart përkushtimin e mësimdhënësve në zbatim të Kornizës kurrikulare. Kurrikula paraqet sfida të ndryshme të cilat mund të tejkalohen duke bashkëpunuar me kolegët tjerë të shkollës dhe komunitetin. Mësimdhënësit inkurajohen të vënë në zbatim përvojat dhe ekspertizën e tyre në zbatim të këtij dokumenti. Njëherit, ju sigurojmë se do të keni mbështetjen tonë në vazhdimësi për të zbatuar me sukses Kornizën dhe dokument tjera kurrikulare.

Sinqerisht,

Prof. dr. Arsim Bajrami

PËRMBAJTJA

Vendimi	4
Fjala e Ministrit	7
Shkurtesat	9
Hyrje	10
PJESA I. KORNIZA KURRIKULARE E KOSOVËS-Organizimi, roli dhe funksioni	13
Organizimi, roli dhe funksioni i Kornizës së Kurrikulës	14
Synimi	15
1. Qëllimet në arsimin parauniversitar	15
2. Kompetencat kryesore të nxënësve	16
3. Parimet e Kornizës së Kurrikulës dhe të sistemit të arsimit parauniversitar	25
4. Struktura e arsimit parauniversitar-nivelet formale dhe shkallët kryesore të kurrikulës	29
4.1. Veçoritë e niveleve formale të arsimit parauniversitar dhe relacionet me kurrikulën	30
4.2. Shkallët e kryesore të kurrikulës - roli i tyre në organizimin dhe vlerësimin e punës edukativo-arsimore në shkollë	33
5. Fushat e kurrikulës, lëndët dhe modulet mësimore.	38
6. Kurrikula me bazë shkolle-mësimi me zgjedhje dhe aktivitetet tjera.	45
7. Plani mësimor	47
8. Sistemi i vlerësimit të nxënësve	47
9. Dokumentet që dalin nga Korniza e Kurrikulës	51
PJESA II. ZBATIMI I KORNIZËS KURRIKULARE	55
Sigurimi i një mjedisi të favorshëm në shkollë për zbatimin e kurrikulës	56
Fjalorthi	59
Bibliografia	69
Hartuesit dhe kontribuesit në rishikim	74
Lista e kontaktit	75

SHKURTESAT

DVSM	Divizioni për vlerësim, standarde dhe monitorim
SWAP	Projekti i qasjes tërësektoriale i BE-së
IBE	Zyra ndërkombëtare për Arsim e UNESCO-s
IT	Teknologji informative
KK	Korniza Kurrikulare
KSNA	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (UNESKO)
KSHKK	Këshilli Shtetëror i Kurrikulave i Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
RN	Rezultatet e të nxënit
SBASHK	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
Shk	Shkallët e kurrikulës
SHMN	Shkencat Matematiko Natyrore
SHPSH	Shkollat për promovimin e shëndetit
TIK	Teknologjia e informimit dhe komunikimit
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
UP	Universiteti i Prishtinës

HYRJE

Nevojat për ndryshim të kurrikulës

Spektori i arsimit në Kosovë karakterizohet për përpjekje të vazhdueshme për t'u reformuar në të gjithë nënsektorët, që trajtojnë sfidat kryesore të rritjes së pjesëmarrjes në arsim dhe përmirësimin e cilësisë.

Gjatë dekadës së fundit janë miratuar akte të shumta ligjore e nënligjore, janë ndërtuar shumë shkolla dhe janë themeluar institucione të reja arsimore. Në vazhdimësi ka pasur përpjekje për zhvillimin e kurrikulave dhe hartimin e sigurimin e teksteve të reja shkollore.

Me gjithë arritjet në reformat arsimore mbeten edhe shumë sfida me të cilat duhet përballur. Për të zbatuar politikat e reja në arsimin parauniversitar duhet punuar në drejtim të rritjes së numrit të mësuesve të aftësuar, duhet siguruar mjetet mësimore cilësore si dhe hapësirë të mjaftueshme me qëllim të përfshirjes së gjithë fëmijëve/të rinjve në shkollim. Për shkak të lëvizjeve demografike fshat – qytet, sidomos në dekadat e fundit, statistikisht tregojnë se shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, në zonat rurale dhe urbane, nuk janë të populluara njëtrajtësisht (shkollat urbane janë të mbingarkuara, ndërsa shkollat rurale janë gjysmë të zbrazëta). Në këtë kontekst shumë shkolla në zonat urbane punojnë ende në dy ndërresa (turne), që nënkupton klasa të ngarkuara dhe mosqëndrim të rëndësishëm në shkollë. Për përkujdesjen dhe zhvillimin për fëmijërinë e hershme vazhdon të ketë mungesë të mësuesve/edukatorëve të kualifikuar e të aftësuar për arsimin parashkollor. Kjo ndikon në cilësinë e edukimit të këtyre grupmoshave.

Rritja e përfshirjes së nxënësve në shkollim, përmirësimi i shkallës së mbarimit të shkollimit dhe të drejtat e barabarta gjinore do të varen nga përmirësimi i cilësisë në arsim, nga sigurimi i shpërndarjes së barabartë të burimeve dhe nga eliminimi i shkaqeve për ndërprerjen e shkollimit nga ana e fëmijëve që vijnë nga familjet e varfëra dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë.

Sfidat me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare:

• **Nevoja për ndërtimin e një shoqërie të dijes:**

Për shkak të zhvillimeve të shpejta shkencore, teknologjike dhe shoqërore, mundësia për të zgjeruar dijen është e madhe. Sot, dija konsiderohet kapitali më i rëndësishëm për gjenerim të ideve të reja dhe të mirëqenies. Për shkak të mundësisë së pakufizuar të marrjes së informatave dhe nevojës për t'u ballafaquar me kontekste dhe sfida të reja të një shoqërie të dijes, në shkollë nxënësit duhet ndihmuar që krahas kompetencave të përgjithshme për jetë dhe punë, të zhvillojnë edhe kompetencat adekuate për qasje dhe përpunim të informatave në mënyrë të pavarur.

• **Integrimi në epokën digjitale:**

Shoqëria e dijes gjeneron dije e zhvillim, por zhvillohet edhe vetë në kontekstin e epokës së teknologjisë digjitale. Për t'u integruar me sukses në ekonominë digjitale, nxënësve iu nevojiten kompetenca digjitale. Prandaj, krahas njohurive themelore që fitohen nga shkrim-leximi dhe

numërimi, sistemi aktual i arsimit nënkupton vetëdijesimin mbi zhvillimin dhe funksionalizimin e kompetencave digjitale. Megjithatë, vetëm njohuritë dhe shkathtësitë digjitale nuk mjaftojnë për të krijuar personalitete komplekse, sepse forcën kryesore të botës edhe në epokën digjitale, e përbëjnë njerëzit dhe vlerat themelore që ata promovojnë.

• Rritja e ndërvarësisë dhe e lëvizshmërisë:

Në saje të ndikimit të aspekteve të ndryshme të globalizimit (për shembull, në sferën e komunikimit, të kapitalit, të udhëtimit, të arsimit, të kulturës, të migrimit, të stilit të jetesës), të gjitha vendet e botës sot janë gjithnjë e më të ndërvarura. Ndërvarësia e botës së sotme, si dhe zhvillimet e reja në tregun e punës kërkojnë sigurimin e parakushteve për lëvizje dhe konkurrencë të suksesshme të të rinjve në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Kjo ka ndikim edhe në identitetin individual dhe kolektiv dhe në perceptimin: "universale" apo "ndërkombëtare", krahasuar me atë që konsiderohet tradicionale, lokale, shtetërore dhe kombëtare. Sot, të rinjtë, më shumë se kurdoherë më parë, duhet të jenë të pajisur me dije e shkathtësi për të qenë në gjendje të përballen me ndryshimet e shpejta e të paparashikueshme, që po ndodhin në botë. Krizat ekonomike dhe financiare, përhapja e sëmundjeve ngjithëse, terrorizmi ndërkombëtar, ndryshimet klimatike janë sfida me të cilat po ballafaqohet bota bashkëkohore.

• Të mësuarit për të jetuar së bashku:

Paraqet një ndër sfidat kryesore në një botë të hapur dhe të ndërvarur, përfshirë menaxhimin konstruktiv të dallimeve, zgjidhjen paqësore të konflikteve, tolerancën, respektin për vetveten, respektin për të tjerët, mirëkuptimin ndërkulturor si dhe komunikimin efektiv. Për Kosovën, si shoqëri shumetnike, "të mësuarit për të jetuar së bashku" është një sfidë dhe prioritet, kur merret parasysh procesi i integritimit në Bashkimin Evropian, ku Kosova synon të marrë pjesë aktive. Kjo përfshin promovimin e vlerave dhe të praktikave që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen, vizionin ndërkulturor, qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut në kontekstin e jetës publike, profesionale dhe private.

• Zhvillimi i qëndrueshëm:

Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, ku cilësia e jetës në tokë, për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, është e kërcënuar, nxënësit duhet të pajisen me dije, me shkathtësi dhe me qëndrime për t'u kujdesur me përgjegjësi për mjedisin e krijuar nga natyra dhe nga dora e njeriut, në mënyrë që t'u shmangen shpërdorimit të burimeve dhe praktikave të tjera të papërgjegjshme. Kjo kërkon që të rinjtë të vetëdijesohen jo vetëm për parimet dhe përvojat e kohezionit shoqëror dhe gjithëpërfshirjes, por edhe se si të luftohen varfëria, marginalizimi, diskriminimi dhe padrejtësia në mënyrë sa më efektive.

• Diaspora dhe mërgata:

Lëvizjet e mëdha të popullsisë së Kosovës (emigrimet dhe rimigrimet) dhe rritja e vazhdueshme e diasporës dhe e mërgatës, në kushtet e një komunikimi dinamik (në veçanti shumëmedial), si në rrafsh global (me synimet kah konsolidimi i kompetencës ndërkulturore), ashtu edhe brenda njësisë kulturore/etnike konkrete (konsistenca në rrafshin identitar/kombëtar dhe integritet në këtë fushë) imponojnë një qasje e angazhim më kompleks e më komplementar për diasporën dhe mërgatën. Në këtë kontekst të rinjtë/të rejtat e Kosovës identifikohen jo vetëm me të qenët

në fokus më të zgjeruar, por edhe si bërës/subjekte të ndërveprimeve kulturore e arsimore në rrafshet Kosovë-diasporë/ mërgatë dhe anasjelltas.

Përballja me sfidat e lartpërmendura kërkon një reformë të plotë të kurrikulës për arsimin parauniversitar, sigurimin e kushteve dhe mbështetjen e nevojshme për zbatimin e saj.

Hapi i parë në reformimin e arsimit parauniversitar është hartimi i Kornizës së Kurrikulës, që vendos themelet për ngritjen e cilësisë dhe barazisë në shërbimet arsimore për të gjithë nxënësit. Kjo nënkupton ndërlidhjen e sistemit të arsimit me synimet dhe reformat aktuale arsimore me sistemet më të zhvilluara.

1

KORNIZA KURRIKULARE

Organizimi, roli dhe funksioni

Organizimi, roli dhe funksioni i kornizës kurrikulare

Korniza Kurrikulare (KK) përbëhet nga tërësi dokumentesh dhe masash të përcaktuara për zbatimin e saj. Këto dokumente ndahen në dy pjesë kryesore:

- Pjesën konceptuale, që është vetë Korniza Kurrikulare dhe
- Pjesën zbatuese - që e përbëjnë dokumentet shoqëruese, të cilat mundësojnë zbatimin e KK-së në nivel të sistemit arsimor duke përcaktuar qartë pritshmërinë nga nxënësit, nga mësuesit dhe nga shkollat.

Roli dhe funksioni i këtyre dokumenteve do të zërthehet në kapitullin VI – Komponenti operativ i dokumentit.

Me Kornizën Kurrikulare, si dokument bazë i arsimit, rregullohet sistemi i arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Me këtë dokument përcaktohen:

- Qëllimet e arsimit parauniversitar, realizimi i të cilave obligon të gjitha institucionet arsimore dhe aktorët tjerë pjesëmarrës në procesin edukativ në Republikën e Kosovës.
- Kompetencat kryesore, të cilat duhet të zhvillohen dhe arrihen nga të gjithë nxënësit deri në përfundim të shkollimit të mesëm të lartë.
- Parimet kryesore për të udhëhequr procesin e hartimit dhe të zbatimit të Kurrikulës në Republikën e Kosovës.
- Nivelet formale dhe profilet e arsimit nga perspektiva e reformës së Kurrikulës.
- Fushat Kurrikulare dhe lëndët mësimore, fushëveprimin e tyre nëpër shkallët kurrikulare dhe minimumin e kohës së ndarë për secilën fushë gjatë një shkalle kurrikulare.
- Hierarkinë e dokumenteve kurrikulare, përfshirë funksionin, përmbajtjen dhe çështjet genësore që duhet të trajtohen në kuadër të dokumenteve të ndryshme që e përbëjnë tërësinë e Kurrikulës.
- Parimet, llojet, kohën dhe mënyrën e vlerësimit të paraparë me Kurrikulë.
- Orientimet për hartimin e materialeve të reja të mësimdhënies dhe nxënies.
- Rolin e shkollës në funksion të zbatimit të Kurrikulës.

Synimi

Me Kornizën kurrikulare synohet që fëmijët dhe të rinjtë/ të rejat e Kosovës të përgatiten për t'u përballur me sfidat e shekulli XXI dhe të gjenerojnë dije të reja konkurruese në mënyrë aktive për tregun global të punës. Korniza kurrikulare rregullon sistemin e arsimit parauniversitar të Kosovës.

1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar parashihet që qëllimet e arsimit të të rinjtë/ të rejat të arrihen nëpërmjet zhvillimit të dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike. Kjo u mundëson të rinjve të jenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, të përballen në mënyrë konstruktive me dallimet dhe sfidat si dhe të respektojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve.

Arsimi në Kosovë nxënësve do t'u krijojë kushte për zhvillim të pavarur, në mënyrë që të përmbushin jetën e tyre personale dhe të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien e shoqërisë kosovare.

Në këtë kontekst, qëllimet e arsimit janë:

- kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore
- promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare
- zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit
- aftësi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore
- zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm
- aftësi për mësim gjatë gjithë jetës.

Arsimi do t'u mundësojë nxënësve që të kuptojnë, të respektojnë dhe të kultivojnë traditat kombëtare dhe të komunitetit ku jetojnë, të vlerësojnë traditat e familjes, të kultivojnë dhe të kontribuojnë në pasurimin e trashëgimisë së tyre kulturore, të rajonit ku jetojnë dhe më gjerë.

Nxënësit do të aftësohen që të shfrytëzojnë në mënyrë kreative/krijuese dijen dhe shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme dhe kontekste të reja; të angazhohen në mënyrë individuale dhe në bashkëpunim me të tjerët në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve si dhe të ushtrojnë shkathtësitë për mendim të pavarur dhe kritik.

Nxënësit do të përkraken që të zhvillojnë përgjegjësinë për veten dhe për të tjerët, për pasojat e veprimeve personale, si dhe në vetëdijësimin për rëndësinë dhe përgjegjësinë për ndërmarrjen e iniciativave. Ata gjithashtu do të përkraken të zhvillojnë përgjegjësinë për mjedisin në kontekst të vetëdijësimit për arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

Nxënësit do të përkrahen që të zhvillojnë vetëbesimin dhe motivimin pozitiv, si dhe të shfrytëzojnë të drejtat e tyre. Ata do të përkrahen që të kultivojnë kërshtërinë e tyre si dhe qëndrimin pozitiv ndaj së ndryshmes, në kuptim të ideve, fenomeneve, personave, kulturave etj.

Arsimi do t'u mundësojë nxënësve të kontribuojnë me tërë potencialin e tyre në ndërtimin dhe mirëqenien e shoqërisë kosovare, duke zhvilluar njëkohësisht pavarësinë e tyre individuale dhe aftësinë për të ndërtuar jetën që ata i përmbush personalisht.

Qëllimet e përgjithshme të arsimit janë të integruara në rezultatet e përcaktuara të të nxënit, në përmbajtjet mësimore dhe duhet të jenë në kulturën e përditshme të shkollës. Për realizimin e tyre obligohen të gjitha institucionet arsimore dhe aktorët e tjerë që janë pjesëmarrës në procesin edukativo-arsimor të Republikës së Kosovës.

2. Kompetencat kryesore të të nxënit

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të njohurive, shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura.

Kompetencat e parapara me Kornizën e Kurrikulës rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar. Këto kompetenca janë¹:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

¹Kompetencat kryesore të arsimit të Kosovës janë të bazuara dhe të ndërlidhura me tetë Kompetencat Kryesore Evropiane për Nxënie Tërëjetësore (Kornizën Referuese Evropiane).

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet se si kompetencat kryesore zbërthehen më tutje dhe se si ato ndërlidhen mes vete për të dhënë rezultatin në fund të shkollimit parauniversitar.

Kompetencat kryesore	Rezultati përfundimtar
<p>1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Komunikim i drejtë në gjuhën amtare ○ Komunikimi nëpërmjet gjuhëve të huaja ○ Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike ○ Komunikimi nëpërmjet teknologjisë informative ○ Angazhimi dhe kontributi për dialog produktiv ○ Respektimi i rregullave të komunikimit ○ Dhënia dhe pranimi i informatës kthyesë në mënyrë konstruktive ○ Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim ○ Inicimi i veprimeve konstruktive 	<p>Komunikues efektiv</p>
<p>2. Kompetenca e të menduarit</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Kompetencat matematikore dhe kompetencat themelore në shkencë dhe në teknologji ○ Kompetencat digjitale ○ Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit ○ Zhvillimi i mendimit abstrakt ○ Marrja e vendimeve të bazuara në informacione të verifikuara ○ Lidhja e vendimeve me pasojat ○ Vlerësimi dhe vetëvlerësimi ○ Zgjidhja e problemeve 	<p>Mendimtar kreativ dhe kritik</p>
<p>3. Kompetenca e të mësuarit</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit ○ Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit ○ Zotërimi i mirëfilltë i leximit, i shkrimit, i matematikës, i shkencës, i teknologjisë së informacionit e komunikimeve ○ Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme ○ Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive 	<p>Nxënës i suksesshëm</p>

<p>4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon ○ Punë e pavarur dhe si pjesë e ekipeve punuese ○ Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore ○ Dëshmim i shkathtësive ndërmarrëse, i njohurive për planifikim të punës, i shfrytëzimit racional të kohës ○ Zotërim i aftësive për menaxhim të konflikteve dhe vlerësim të rreziqeve ○ Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme ○ Angazhim për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit 	<p>Kontribues produktiv</p>
<p>5. Kompetenca personale</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Dëshmim i të njohurit të vetes dhe të tjerëve ○ Dëshmim i vetëbesimit ○ Menaxhim i emocioneve dhe i stresit ○ Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët ○ Dëshmim i aftësive për të bërë jetë të shëndoshë ○ Bërja e zgjedhjeve të përgjegjshme për shëndetin personal 	<p>Individ i shëndoshë</p>
<p>6. Kompetenca qytetare</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore ○ Mirëkuptim dhe respektim i dallimeve ndërmjet njerëzve ○ Tolerancë dhe respekt për të tjerët ○ Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare ○ Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin 	<p>Qytetar i përgjegjshëm</p>

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit ("Komunikues efektiv")

Me qëllim që fëmijët dhe të rinjtë/të rejtat të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike.

Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësi përkrahet që të shfrytëzojë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative/krijuese mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

Rezultatet e të nxënit për Kompetencën e Komunikimit dhe e të Shprehurit ("Komunikues efektiv")

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të komunikojnë dhe të shprehen nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave dhe kodeve;
- të flasin, të dëgjojnë, të lexojnë e të shkruajnë dhe të shprehen në gjuhën amtare dhe në (së paku) një gjuhë tjetër të huaj;
- të angazhohen dhe të kontribuojnë në dialog të respektueshëm dhe produktiv;
- të japin dhe të pranojnë informata kthyesë në mënyrë konstruktive dhe kreative;
- të respektojnë rregullat e përgjithshme të komunikimit/ndërveprimit dhe njëkohësisht të jenë kreativë;
- të përdorin programet e TIK-ut gjatë procesit të nxënies dhe kryerjes së detyrave shkollore;
- të përdorin TIK-un dhe mediet në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme si mjete të rëndësishme të informimit, të komunikimit dhe të ndërveprimit në epokën digjitale.

Kompetencën e të menduarit ("Mendimtar kreativ dhe kritik")

Qasja në njohuri dhe përpunimi i tyre në mënyrë të pavarur, efektive dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, për të marrë vendime dhe veprime për të zgjidhur probleme në mënyrë të vetëdijshme për ndikimin dhe pasojat e tyre. Duke pasur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë thelbësore për shekullin XXI. Megjithatë, përveç aftësisë për të identifikuar dhe për t'iu qasur informatës/burimit të njohurisë së caktuar, nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë edhe kapacitete për t'iu qasur njohurive në mënyrë kritike, kreative dhe ndërvepruese.

Rezultatet e të nxënit për Kompetencën e të menduarit, ("Mendimtar kreativ dhe kritik")

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhen të jetë në gjendje:

- të identifikojnë, të lokalizojnë dhe t'i qasen informatës së duhur;
- të përpunojnë në mënyrë kritike informatën (të analizojnë, të sintetizojnë, të organizojnë, të shfrytëzojnë dhe të zbatojnë);
- të zbatojnë njohurinë në kontekst të zgjidhjes së problemit nëpërmjet veprimeve të përshtatshme;
- të gjykojnë drejt, në bazë të analizës dhe sintezës paraprake të fakteve dhe situatave;
- të ilustronë me mjete konkrete të menduarit abstrakt;
- të vlerësojnë mundësitë e ndryshme dhe të marrin vendime të drejta;
- të lidhin vendimet e tyre me pasojat në mënyrë të përgjegjshme;
- të vlerësojnë cilësinë e informatave, rëndësinë e tyre dhe vlerën kundrejt qëllimit për të cilin nevojiten informatat e caktuara;
- të vetëvlerësojnë paraqitjen vetjake krahas rezultateve të pritura;
- të menaxhojnë informatat në mënyrë kritike, kreative/krijuese dhe të përgjegjshme;
- të bëjnë zgjidhjen e problemeve në nivelin e caktuar të vështirësisë.

Kompetenca e të mësuarit ("Nxënës i suksesshëm")

Meqenëse dinamika e zhvillimeve në shoqëri, shkencë, teknologji dhe ekonomi është shumë e shpejtë, nuk mund të pretendohet që të gjitha njohuritë, shkathtësitë e aftësitë e nevojshme të arrihen nëpërmjet shkollimit. Prandaj, në shkollë pritet që nxënësve t`u jepet një bazë e mirë e arsimit dhe përgatitje për nxenie tërëjetësore.

Për një "nxënës të suksesshëm" i gjithë stafi i shkollës angazhohet të kultivojë/nxisë vazhdimisht kërkueshmëri dhe natyrshme të nxënësve dhe interesimin për të nxënë si dhe të zhvillojë kompetencën për të mësuar/nxënë. Ai po ashtu duhet të vetëdijësohet për rëndësinë e respektimit të stileve të ndryshme të nxënies së nxënësve dhe përdorimit të strategjive efektive mësimore.

Rezultatet e të nxënit për Kompetencën e të mësuarit ("Nxënës i suksesshëm")

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të kuptojnë dhe të çmojnë nevojën për mësim gjatë tërë jetës;
- të demonstrojnë shkathtësi funksionale në shkrim-lexim, në matematikë, në shkencë, në TIK dhe në situata të përditshme;
- të njohin përparësitë dhe dobësitë e tyre dhe stilet e strategjitë e preferuara të të nxënit;
- të mbështesin njohuritë e reja mbi përvojat paraprake dhe t'i shfrytëzojnë ato;
- të vendosin dhe të prioritetizojnë qëllimet e tyre të të nxënit;
- të ndjekin përparimin e vet dhe të bëjnë ndërhyrjet e nevojshme për t`u përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme;
- të kultivojnë motivimin e tyre për mësim;
- të mësojnë duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike;
- të kërkojnë dhe të shfrytëzojnë këshillat, informatat dhe përkrahjen kur është e nevojshme;
- të ndërmarrin iniciativa, të vlerësojnë rreziqet dhe të përballen me vështirësitë në të nxënë;
- të menaxhojnë burimet që i kanë, kohën, njerëzit dhe mjedisin e tyre në mënyrë produktive dhe të përgjegjshme;
- të bashkëpunojnë me të tjerët, në procesin e të nxënit;
- të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme;
- të vlerësojnë në mënyrë kritike punën e tyre duke iu referuar qëllimeve fillestare.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis ("Kontribues produktiv")

Nxënësit duhet të përgatiten për të jetuar dhe për të punuar në një botë shumë të ndërvarur dhe për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Qytetarit të shekullit XXI i duhet kompetenca për jetë, punë dhe mjedis për t'u përballur me rrethana dhe sfida të paparashikueshme, si dhe kapacitete për t'i shfrytëzuar mundësitë që i ofrohen për përparim personal, shoqëror e mjedisor.

Për të zhvilluar këtë kompetencë nxënësit përkrahen që të kuptojnë në mënyrë të plotë ndërvarësinë ndërmjet fenomeneve ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë lokale dhe globale. Te ata/ato të kultivohet orientimi drejt së ardhmes, ndërmarrësisë dhe motivimi i vazhdueshëm për të përmbushur objektivat. Njëkohësisht, duke e pasur parasysht arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, nxënësit përgatiten që të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Rezultatet e të nxënit për Kompetencën për jetë, për punë dhe për mjedis, ("Kontribues produktiv")

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të prezantojnë veten me shkrim dhe me gojë, duke përpiluar CV (biografinë) në formatet e kërkuara;
- të zotërojnë kompetencat e nevojshme për situatat e ndryshme jetësore dhe shtigjet e ndryshme të karrierës;
- të hulumtojnë dhe t'u qasen mundësive relevante për arsimim, përgatitje profesionale dhe për këshillim;
- të manifestojnë shkathtësi organizative, aftësi për të marrë iniciativa dhe për punë ekipore;
- të planifikojnë dhe të menaxhojnë projekte për të arritur objektiva të caktuara (udhëheqje, delegim, analizë, komunikim, raportim, vlerësim, monitorim, mentorim);
- të identifikojnë dhe të vlerësojnë burimet e nevojshme (p.sh. kohën, mjetet financiare, burimet njerëzore);
- të tregojnë fleksibilitet, kreativitet, kapacitet për t'iu përshtatur rrethanave të reja dhe përgjegjshmëri gjatë realizimit të një detyre;
- të manifestojnë vetiniciativë;
- të demonstrojnë ndjenjën e solidaritetit dhe të garës së drejtë gjatë realizimit të detyrave të caktuara.

Kompetenca personale ("Individ i shëndoshë")

Për të zhvilluar kompetencën personale, nxënësit përgatiten që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare, shoqërore dhe të punës. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen që të vetëdijesohen për veten dhe të kenë vetëbesim, por njëkohësisht të jenë të hapur dhe të kenë besim te të tjerët.

Rezultatet e të nxënit për Kompetencën personale ("Individ i shëndoshë")

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të demonstrojnë vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale;
- të njohin përparësitë dhe dobësitë e tyre, të përparojnë tutje duke u mbështetur në përparësitë e tyre dhe të punojnë për kapërcimin e dobësive/mangësive;
- të njohin dhe të menaxhojnë emocionet e tyre;
- të bashkëpunojnë dhe të bashkëndiejnë me të tjerët;
- të njohin, të respektojnë dhe të çmojnë kulturën e tyre si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve;
- të flakin paragjykimet dhe të bëjnë kompromise në raste të caktuara;
- të menaxhojnë stresin, traumat dhe të zgjidhin konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive;
- të kuptojnë dhe t'u përmbahen kodeve të sjelljes në situata të ndryshme;
- të kuptojnë mënyrën e jetës së shëndetshme;
- të bëjnë zgjedhje dhe të marrin vendime të informuara lidhur me shëndetin, dietat dhe ushtrimet;
- të ndjekin planet personale të jetesës dhe të vlerësojnë nëse i kanë arritur qëllimet e synuara dhe në çfarë niveli;
- të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të veta.

Kompetenca qytetare ("Qytetar i përgjegjshëm")

Të mësuarit për të jetuar së bashku trajtohet si sfida kryesore e botës së sotme dhe të së nesërme. Qytetaria shtetërore sot plotësohet me aspektin shumë të rëndësishëm të "qytetarisë globale". Kjo kompetencë siguron që nxënësit të jenë në gjendje të veprojnë si qytetarë të përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë.

Rezultatet e të nxënit për Kompetencën qytetare ("Qytetar i përgjegjshëm")

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të kuptojnë mjedisin e tyre shoqëror, në nivel lokal, shtetëror dhe më të gjerë dhe mënyrën e funksionimit të tij (p.sh. strukturën, kulturën, shprehitë, rregullat dhe pritshmëritë);
- të mbështesin të drejtat e njeriut si bazë e demokracisë;
- të kuptojnë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre si dhe të njohin e të respektojnë të drejtat e të tjerëve;
- të vlerësojnë diversitetet dhe të demonstrojnë tolerancë, mirëkuptim, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
- të menaxhojnë dhe të zgjidhin konfliktet në mënyrë konstruktive dhe të paanshme;
- të marrin pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në të gjitha nivelet (p.sh. në familje, në shkollë, në komunitet lokal/aktivitete të lagjes, si dhe në proceset e politikave lokale dhe shtetërore);
- të demonstrojnë vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme (p.sh. respekti i dinjitetit personal, luftimi i paragjyqimeve dhe diskriminimit të të gjitha llojeve; luftimi i varfërisë dhe i marginalizimit; promovimi i barazisë gjinore);
- të tregojnë interes për çështjet publike dhe të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve në nivel shkolle dhe komuniteti;
- të mbrojnë mjedisin natyror dhe artificial dhe të kontribuojnë për zhvillim të qëndrueshëm.

3. Parimet e Kornizës Kurrikulare dhe të sistemit të arsimit parauniversitar

Korniza kurrikulare është e ndërtuar mbi parime që vlejné për tërë sistemin e arsimit parauniversitar. Ato sigurojnë koherencën dhe konsistencën e këtij sistemi.

Parimet janë referenca për hartimin e kurrikulave bërthamë dhe të të gjitha dokumenteve të tjera të kurrikulare (shih hierarkinë e dokumenteve të kurrikulës në kapitullin: Dokumentet që dalin nga Korniza Kurrikulare).

Parimet për zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Kurrikulare janë:

Gjithëpërfshirja

Ky parim i referohet të drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për qasje dhe përfshirje të barabartë në arsimim cilësor.

E udhëhequr nga ky parim, Korniza Kurrikulare ofron zgjidhje të modifikueshme për t'i trajtuar dallimet e nxënësve në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuar që çdo fëmijë\nxënësi t'i ofrohet mundësia që të shpalosë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar, i vlerësuar dhe të përfitojë maksimalisht nga procesi mësimor.

Në këtë kontekst, Korniza Kurrikulare promovon:

- a) mjedis mësimor që mundëson qasje, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit;
- b) promovimin e nxënies dhe pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor për të gjithë nxënësit, përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta, talentët, gjenitë dhe ata me vështirësi në të nxënë;
- c) të nxënit që reflekton përvojat dhe informacionet paraprake të nxënësve; interesimet, potencialet, mundësitë, nevojat dhe stilet e të nxënit të tyre;
- d) planifikim të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat, përvojat dhe stilet e ndryshme të mësimnxënies se secilit nxënë;
- e) përfshirjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e përvojave të të nxënit, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e tyre dhe për të qenë në gjendje për të vetëvlerësuar rezultatet vetjake të të nxënit.

Realizimi i mundësive të lartpërmendura siguron përmirësimin e vijueshmërisë në shkollë dhe nivelin e arritjes së nxënësve.

Zhvillimi i kompetencave

Korniza kurrikulare përcakton qartë kompetencat, të cilat shoqëria dhe ekspertët arsimorë i konsiderojnë të domosdoshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, që pritet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit me përfundimin e shkollës së mesme të lartë.

Ndërsa në Kurrikulat Bërthamë (KB), kompetencat reflektohen nëpërmjet një sistemi të Rezultateve të të Nxënësve (RN), që duhen të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit.

Qasja e zhvillimit të kompetencave siguron:

- (a) mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit për nxënie bazuar në nevojat individuale,
- (b) vlerësim të drejtë të nivelit të arritjes së kompetencave nga nxënësi, dhe
- (c) vlerësim të saktë të cilësisë së arsimit që ofrohet në nivel vendi, komune apo shkolle.

Përcaktimi i rezultateve të pritura, që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit, njëkohësisht mundëson edhe akreditimin e programeve të ndryshme arsimore, që ofrohen në kuadër të arsimit joformal. Me këtë njëkohësisht mundësohet edhe lëvizshmëria ndërmjet arsimit formal dhe joformal, nëpërmjet procesit të njohjes së dijes paraprake, me të cilën do të përfitojë dukshëm arsimimi i të rriturve dhe format e tjera të arsimit joformal.

Mësimdhënia dhe të nxënësve të integruar dhe koherent/të ndërlidhur

Korniza kurrikulare promovon të nxënësve holistik (të plotë/tërësishëm), që reflekton ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me dijen dhe informacionin që nxënësit kanë për to.

Në këtë kontekst, kurrikula do të përfshijë:

- (a) rekomandime të qarta për planifikimin e përvojave mësimore për të mbështetur nxënësit përgjatë tërësisë së sistemit të arsimit parauniversitar drejt zotërimit të kompetencave të përcaktuara dhe
- (b) kriteret e vlerësimit për të konstatuar saktësisht nivelin e arritjes së nxënësve në periudha të caktuara kohore.

Për të mundësuar një qasje të tillë, korniza kurrikulare parasheh:

- Promovimin e të nxënësve të integruar nëpërmjet fushave kurrikulare, në kuadër të të cilave përmbajtja lëndore është e ndërlidhur me çështjet ndërkurrikulare dhe kontribuon në zhvillimin e kompetencave (për shembull, integrimi i shkencave natyrore dhe integrimi i

shkencave shoqërore në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët);

- Ndërlidhjen ndërmjet fushave të ndryshme kurrikulare në funksion të një procesi holistik dhe të shumanshëm mësimor, duke u mundësuar nxënësve konfirmimin e ndërlidhjes së të gjitha aspekteve të procesit mësimor, të të gjitha përvojave mësimore në kuadër të fushave të ndryshme kurrikulare.
- Ndërlidhjen ndërmjet aspekteve konceptuale dhe dimensioneve praktike, si zbatimi i dijes dhe shfrytëzimi i shkathtësive, i qëndrimeve dhe i vlerave të caktuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale të jetës së përditshme.
- Promovimin e ndërlidhjes ndërpërmbajtësore me qëllim të promovimit të edukimit për zhvillim të qëndrueshëm.
- Integrimin e risive, që reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore apo të shkencës në funksion të arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.
- Perspektivën e të nxënësve gjatë gjithë jetës: Kurrikula do t'u mundësojë nxënësve të përgatiten që të ballafaqohen me sukses në jetën e tyre të përditshme me sfidat e vazhdueshme dhe me mundësitë që ofron një shoqëri e dijes dhe e të nxënësve, duke u kushtuar vëmendje të veçantë: mësimi për të nxënë, zotësisë për vlerësimin dhe procedimin efektiv e të ndërgjegjshëm të informacionit, të nxënësve elektronik dhe aftësisë për shfrytëzimin e teknologjive të epokës digjitale (si: teknologjia e komunikimit dhe e informimit, të nxënësve elektronik, si mënyrë e të menduarit dhe e të vepruarit, vetëdijësimi për mediet, shkathtësitë proaktive jetësore).

Autonomi dhe fleksibilitet në nivel shkolle

Me kornizën kurrikulare rregullohen qartë normat e autonomisë dhe të fleksibilitetit në nivel shkolle. Kjo ka të bëjë me mundësinë dhe përgjegjësinë e stafit të shkollës për:

- Hartimin e planit vjetor të punës dhe shfrytëzimin fleksibil të kohës mësimore duke mundësuar organizimin e orëve mësimore mbi minimumin e përcaktuar me KK për fusha kurrikulare, respektivisht lëndë mësimore si planifikimin e orëve të mësimi plotësues, shtues, planifikimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare (jashtëkurrikulare), e formave të mësimdhënies interaktive, mjeteve mësimore dhe çështjeve të tjera në kontekstin e mësimdhënies dhe nxënies holistike dhe zhvillimit të kompetencave.
- *Planifikimin dhe shfrytëzimin e pjesës zgjedhore të kurrikulës, përfshirë mundësinë për:*
 - (a) rritjen e fondit të orëve në kuadër të fushave përkatëse kurrikulare dhe
 - (b) zhvillimin dhe zbatimin e elementeve plotësuese kurrikulare për të përmbushur nevojat dhe interesat e veçanta të nxënësve si dhe për të reflektuar rrethanat në të cilat shkolla përkatëse vepron.

Përgjegjësia dhe llogaridhënia

Korniza kurrikulare, krahas promovimit të autonomisë dhe fleksibilitetit në nivel shkolle, parasheh edhe vendosjen e një mekanizmi të qartë të llogaridhënies për tërë hierarkinë e sistemit të arsimit. Përgjegjësia dhe llogaridhënia i referohen si procesit të zbatimit të kornizës së kurrikulës ashtu dhe sistemit të arsimit në tërësinë e tij.

Gjatë procesit të zbatimit të kurrikulës, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe krijimit të një kulture të vlerësimit të vazhdueshëm, që nënkupton idenë që ndjekja e progresit në zbatimin e kërkesave të kurrikulës të bëhet pjesë normale e funksionimit të shkollave. Në suaza të këtij procesi, kuadri mësimor, kuadri drejtues i shkollave dhe autoritetet komunale të arsimit do të përfshihen në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt një paraqitjeje më të mirë në përmbushjen e kërkesave të kurrikulës dhe ngritjes së cilësisë së arsimit.

Në këtë kontekst, zbatimi i kurrikulës shtetërore në nivel shkolle bëhet përmes:

- Angazhimit aktiv të shkollës në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të përvojave të mësimdhënies dhe të të nxënësve drejt ngritjes së nivelit të arritjeve të nxënësve;
- Angazhimit të shkollave dhe komunave në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt përmbushjes së kërkesave të kurrikulës shtetërore;
- Monitorimit, mbështetjes, raportimit dhe llogaridhënies.

4. Struktura e arsimit parauniversitar - nivelet formale dhe shkallët kryesore të kurrikulës

Roli i niveleve formale dhe shkallët kryesore të kurrikulës në organizimin e punës edukativo-arsimore në shkollë

Struktura e arsimit në Kosovë është në harmoni me Klasifikimin Standardit Ndërkombëtar të Arsimit si në tabelën e mëposhtme:

Nivelet sipas KSNA ¹		Nivelet Formale të Arsimit Parauniversitar në Kosovë ²	Mosha
		Arsimimi i të rriturve/Arsimimi gjatë tërë jetës në shkallë të gjerë (formal dhe joformal)	23/24+
KSNA 6		Arsimi pasuniversitar	23/24+
KSNA 5		Arsimi universitar	
KSNA 4	Niveli 5 Sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi passekondar jouniversitar	18 +
KSNA 3	Niveli 4 Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Gjimnazi klasa X-XII Shkollat profesionale (klasat X-XII)	Matura 15-17
	Niveli 3 Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Shkollat profesionale (klasat X-XI)	15-16 Shkollat profesionale
KSNA 2		Arsimi i mesëm i ulët Klasat VI-IX	11-14
KSNA 1		Arsimi fillor Klasat I-V	6-10
KSNA 0		Klasa përgatitore	5-6
		Edukimi parashkollor	lindje-5

Nëpër nivele formale të arsimit, nxënësit në mënyrë koherente përgatiten për mësim gjatë tërë jetës dhe për botën e punës në epokën e dijes dhe të digjitalizimit.

Krahasuar me Kornizën e Kualifikimeve, korniza e kurrikulës u referohet vetëm 4 niveleve formale të arsimit dhe 5 niveleve të kualifikimeve. Me këtë ofrohet një bazë e mirë, një platformë e cila në të njëjtën kohë është dritare e hapur drejt arsimimit gjatë tërë jetës dhe arsimimit të të rriturve. Prandaj, në të gjitha shkallët dhe fushat e kurrikulës do të theksohen mundësitë që u ofrohen nxënësve për të arritur kualifikimet kombëtare të bazuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

¹ Klasifikimi Standardi Ndërkombëtar i Arsimit.

² Tri pjesët e fundit nuk janë pjesë të arsimit parauniversitar.

4.1. Veçoritë e niveleve formale të arsimit parauniversitar dhe relacionet me kurrikulën

Edukimi parashkollor

Edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të edukimit, gjatë të cilit fëmijët edukohen në familjet e tyre ose/dhe në institucione parashkollore që nga (mosha 0 - 3 dhe mosha 3-5 vjeç). Pjesë e këtij niveli është edhe klasa përgatitore (mosha e fëmijëve 5-6 vjeç) që mund të organizohet në institucionet parashkollore ose/dhe në klasa përgatitore.

Edukimi parashkollor mbështetet në standardet e zhvillimit dhe të nxënit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç, standarde të cilat mbështesin dhe nxisin zhvillimin optimal të fëmijëve.

Mosha parashkollore paraqet një periudhë të zhvillimit të shpejtë fizik, njohës, emocional dhe social të fëmijëve. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj periudhe të zhvillimit në vendosjen e një baze të mirë për të nxënit gjatë gjithë jetës, ekspozimi i fëmijëve ndaj proceseve elementare të të nxënit do të fokusohet në nxitjen e kërkimit të tyre për veten, për shoqërinë, për natyrën, dijen, kulturën dhe për teknologjitë e reja. Synim i punës edukative në këtë periudhë është edhe stimulimi/nxitja i kreativitetit dhe entuziazmit për qasje ndaj përvojave të reja dhe përballjes me situata reale jetësore.

Gjatë këtij niveli të edukimit, fëmijët përkrahen në zhvillimin e shkathtësisë komunikuese në gjuhën amtare në situata të thjeshta të përditshmërisë, në zhvillimin e vëmendjes së tyre dhe aftësive të përqendrimit si dhe në zhvillimin e shkathtësisë themelore sociale, njohëse, kreativitetit si dhe në zhvillimin e koncepteve themelore matematikore.

Vëmendje e veçantë gjatë kësaj faze i kushtohet zhvillimit fizik nëpërmjet aktiviteteve fizike dhe përvojave që rrisin vetëdijen e fëmijëve për nevojën e mbrojtjes së mirëqenies së tyre fizike si dhe kujdesit për shëndetin dhe sigurinë.

Realizimi i procesit edukativ në nivelin e edukimit parashkollor, që përfshin moshën e fëmijëve 0-6 vjeç, bëhet në mënyrë të integruar.

Klasa përgatitore

Fëmijët në klasën përgatitore në shkollë dhe në institucionet parashkollore, ndihmohen për krijimin e përvojës edukative për ambientim/përshtatje në një formë të sistemuar të të nxënit nëpërmjet lojës-punës-mësimi.

Realizimi i procesit edukativo-mësimor bëhet në mënyrë të integruar, i ndërlidhur me punën dhe jetën e përditshme të fëmijëve, duke ua mundësuar që ta kuptojnë drejt marrëdhënien e tyre me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu.

Në klasën përgatitore (mosha 5-6 vjeç), fëmijët përveç shkathtësisë e shprehive sociale, krijojnë bazat themelore të të nxënit, që përfaqësojnë elementet themelore të leximit, të shkrimit dhe të veprimeve me numra, me çka rritet gatishmëria e tyre për shkollim fillor dhe për jetë.

Arsimi fillor (klasat I - V)

Në këtë nivel, përvojat mësimore në shkollë kontribuojnë për kalimin gradual nga të nxënit përmes lojës në të nxënit më të sistemuar të nxënësve. Puna edukativo-arsimore përqendrohet në përvetësimin e shkrim-leximit themelor, matematikës elementare, njohjes së mjedisit natyror e shoqëror të rrethinës, elementet e edukimit estetik dhe fizik në kontekstin e vendosjes së një baze të shëndoshë për zhvillimin njohës, socio-emocional dhe motorik. Kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv të tij për të nxënit që ndihmon zhvillimin e shprehive themelore për, "mësimin për të nxënë".

Realizimi i procesit mësimor bëhet në mënyrë të integruar, duke mundësuar që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu të kuptohet në mënyrë sa më të plotë.

Në këtë nivel të arsimit, krahas arsimit të përgjithshëm nxënësit me talente mund të vijojnë shkollat artistike. Shkollat artistike themelohen dhe funksionojnë në bazë të kurrikulave dhe legjislacionit përcjellës të veçantë për to. Në këto shkolla nxënësit marrin bazat elementare, orientuese për drejtime të ndryshme artistike.

Arsimi i mesëm i ulët (klasat VI-IX)

Arsimi i mesëm i ulët i përgatit nxënësit që me sukses të përballen me sfida të reja dhe ndihmon zhvillimin e tyre intelektual (njohës), fizik, personal, social dhe moral. Dëshira e tyre për të nxënë, duhet të motivohet më tutje për të siguruar që dija, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e zotëruara në këtë nivel të bëhen bazë e qëndrueshme për të nxënë edhe në nivelet më të larta të arsimit.

Në këtë nivel duke e plotësuar shkrim-leximin themelor, i cili përvetësohet në nivelin paraprak të shkollimit, nxënësit përkrahen që në mënyrë graduale ta përforcojnë atë, duke e bërë funksional dhe të qëndrueshëm përgjatë tërë jetës në aspekte të ndryshme: të informacionit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë. Kjo në thelb nënkupton të nxënit për t'iu qasur informatës në mënyrë efikase dhe efektive, për të vlerësuar atë në mënyrë kritike e me kompetencë dhe për ta shfrytëzuar në mënyrë të saktë dhe kreative.

Krahas plotësimit të shkrimit-leximit themelor, në këtë nivel duhet përkrahur nxënësit në zhvillimin e aspekteve vizuale/pamore dhe digjitale të të nxënit. Aspekti vizual/pamor i referohet përgatitjes së nxënësve për të deshifruar, për të interpretuar dhe për të zbuluar mostrat dhe modelet e dijes si dhe për të shfrytëzuar imagjinatën vizuale për komunikimin e ideve. Ndërkaq, aspekti digjital ndihmon efikasitetin e shfrytëzimit të kohës dhe kreativitetin në të shprehurit dhe komunikimin e ideve, gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve të shumta të informacionit gjatë procesit mësimor (bibliotekat elektronike, uebfaqet e ndryshme shkencore, mediet e besueshme etj.), sistemimin dhe ruajtjen e materialeve dhe detyrave mësimore në formën elektronike, kalkulimet e shpejta dhe të sakta etj.

Kurrikula në këtë nivel pasurohet duke i vënë nxënësit para një spektri më të gjerë të përvojave të të nxënësve (p.sh. kombinimi i qasjeve konceptuale dhe praktike; të menduarit abstrakt dhe veprimet e kontekstualizuara, kontakti me realitetin konkret dhe virtual), në mënyrë që ata të ndihmohen në identifikimin e preferencave/parapëlqimeve dhe fushave të interesimit e të interesit të tyre. Në arsimin e mesëm të ulët nxënësit përgatiten më thellësisht edhe për orientim në karrierë duke u përkrahur me mentorë/këshilltarë profesionalë.

Krahas arsimit të përgjithshëm nxënësit me talente mund të vijojnë shkollat artistike. Shkollat artistike themelohen dhe funksionojnë në bazë të kurrikulave dhe legjislacionit përcjellës të veçantë për to. Në këto shkolla nxënësit thellojnë më tutje njohuritë dhe shkathtësitë në drejtime të ndryshme artistike.

Arsimi i mesëm i lartë (klasat X-XII, gjimnazet dhe shkollat profesionale)

Arsimi i mesëm i lartë është proces më i gjerë/nivel, më i thelluar dhe më i specializuar i të nxënësve. Në këtë nivel duhet pasur parasysh:

- a) zhvillimin e përgjithshëm dhe profesional të nxënësve
- b) orientimin e nxënësve për studime akademike, për kualifikime profesionale (përfshirë arsimin pas sekondar jouniversitar) dhe/apo inkuadrimin në tregun e punës, si dhe
- c) nevojën për t'i përgatitur ata për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Në këtë nivel, në shkollat e përgjithshme (gjimnazet), dhe në shkolla profesionale, procesi i përvetësimit të njohurive/dijeve dhe zhvillimit të shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve bazohet në nevojën për përgatitjen e të rinjve për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, për të marrë pjesë si qytetarë aktivë dhe kompetentë në zhvillimet shoqërore dhe për t'u inkuadruar me sukses në tregun e punës. Prandaj, nxënësit i nënshtrohen një procesi më sfidues të përvetësimit të dijeve, zhvillimit të potencialit të tyre intelektual, emocional, fizik dhe moral.

Llojet e gjimnazeve

Në nivelin e arsimit të mesëm të lartë do të ketë tri lloje të gjimnazeve:

Gjimnaz të shkencave shoqërore dhe gjuhësore,

Gjimnaz të shkencave natyrore, dhe

Gjimnaz të specializuar (artistik, matematikor, gjuhësor, teknik etj.)

Gjimnazet e specializuara themelohen në bazë të nevojave dhe prioriteteve shoqërore dhe shtetërore. Mënyra e themelimit dhe kurrikula e tyre përcaktohet me legjislacion përcjellës të veçantë.

Shkollat profesionale – drejtimet dhe profilet e shkollave profesionale rregullohen me kurrikulën bërthamë të arsimit profesional.

Arsimi passekondar jouniversitar

Arsimi passekondar jouniversitar është nivel i shkollimit pas shkollës së mesme të lartë dhe kandidatët duhet të jenë mbi moshën 18 vjeç. Në sistemin ndërkombëtar të klasifikimit të arsimit, sistemohet në nivelin KSNA 4. Në Kosovë, ky lloj i shkollimit ofrohet nga institucionet e shkollave të mesme teknike, nga shkollat e larta profesionale, por edhe nga institucionet e arsimit universitar.

Bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, diplomat e fituara për këtë nivel të arsimit janë të nivelit 5 të kualifikimeve, të cilat shërbejnë për të dalë në treg të punës, ose për t'u rikualifikuar për punë të caktuara². Kandidatët që tregojnë sukses të lartë në këtë nivel të arsimit, fitojnë të drejtën për t'u regjistruar në studimet universitare edhe pa e arritur minimumin e kërkuar në testin e maturës.

4.2. Shkallët kryesore të Kurrikulës - roli i tyre në organizimin dhe vlerësimin e punës edukativo-arsimore në shkollë

Korniza kurrikulare është e strukturuar në gjashtë shkallë kryesore, të cilat paraqesin periudhat me karakteristika të përbashkëta për sa i përket zhvillimit të fëmijëve dhe kërkesave të kurrikulës. Ato përbëhen prej një, dy ose tre viteve/klasëve. Për secilën shkallë përcaktohen kërkesat standarde të progresit të të nxënësve, organizimi i përvojave mësimore, qasja dhe kriteret e vlerësimit për kompetencat e caktuara në këtë dokument.

Strukturimi dhe organizimi i kurrikulës sipas shkallëve kryesore të kurrikulës mundëson:

- respektimin e karakteristikave të periudhave të ndryshme zhvillimore të fëmijëve dhe të rinjve me rastin e përcaktimit të qëllimeve specifike dhe kompetencave që duhen zotëruar nga fëmijët;
- respektimin e ritmeve individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të parapara për shkallë të caktuara të kurrikulës;
- sigurimin e një qartësie më të madhe në artikullimin e hartimit/shprehjen e rezultateve të pritura të të nxënësve përgjatë shkallëve të kurrikulës si pika referuese për planifikimin dhe organizimin e punës edukativo-arsimore në nivel shkolle;
- sigurimin e udhëzimeve specifike për organizimin e punës edukativo-arsimore gjatë shkallëve të Kurrikulës, me theks të posaçëm në metodat e punës dhe format e vlerësimit;
- rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së shkollës dhe autoriteteve lokale të arsimit për cilësinë e arsimit që ofrohet në nivel shkolle.

²Kompetencat kryesore të arsimit të Kosovës janë të bazuara dhe të ndërlidhura me tetë Kompetencat Kryesore Evropiane për Nxënien Tërëjetësore (Kornizën Referuese Evropiane).

Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit	Nivelet formale të arsimit parauniversitar	Shkallët kryesore të kurrikulës
KSNA 3	Arsimi i mesëm i lartë Klasa XII	Shkalla 6: Konsolidim dhe specializim
	Arsimi i mesëm i lartë Klasat X-XI	Shkalla 5: Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional
KSNA 2	Arsimi i mesëm i ulët Klasat VIII-IX	Shkalla 4: Përforcim dhe orientim
	Arsimi i mesëm i ulët Klasat VI-VII	Shkalla 3: Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim
KSNA 1	Arsimi fillor Klasat III-V	Shkalla 2: Përforcim dhe zhvillim
	Arsimi fillor Klasat I-II	Shkalla 1
KSNA 0	Klasa përgatitore	Përvetësim themelor
	Edukimi parashkollor	Shkalla përgatitore Edukimi në fëmijërinë e hershme

Shkalla përgatitore - Edukimi në fëmijërinë e hershme

Kjo shkallë përfshin periudhën e fëmijës prej lindjes deri në klasën përgatitore (grupmoshën 0 deri 3 vjeç dhe grupmoshën prej 3 deri në 5 vjeç). Gjatë kësaj shkalle, fëmijët nëpërmjet lojës, përkrahen në zhvillimin e hershëm personal, përfshirë:

- zhvillimin e aftësisë për të komunikuar në gjuhën amtare nëpërmjet aktiviteteve që ndihmojnë artikullimin e drejtë të fjalëve, pasurimin e fjalorit dhe ushtrimin e aftësisë për të dëgjuar të tjerët;
- zhvillimin e njohjes si të menduarit, zgjidhja e problemeve, kuptimi i koncepteve, procesimi i informatës dhe inteligjencën e përgjithshme.
- zhvillimin fizik, ushtrimin e koordinimit të lëvizjeve trupore, zhvillimin e forcës, të ekuilibrit, muskujve, koordinimin sy-dorë dhe aftësimin për manipulim me objekte të ndryshme të përdorimit ditor;
- vetëdijesimin gradual për veten, për të tjerët dhe për mjedisin që e rrethon;
- zhvillimin e aftësive për të respektuar rregullat, për të dalluar të drejtën nga e gabuara dhe për të dalluar veprimet që lejohen prej atyre që janë të ndaluara;
- nxitjen dhe aftësimin për t'u angazhuar në mënyrë aktive në aktivitete praktike, për të vlerësuar rreziqet dhe për të respektuar rregullat elementare të higjienës dhe sigurisë.

Shkalla 1 - Përvetësim themelor

Kjo shkallë përfshin klasën përgatitore, klasën I dhe klasën II. Në këtë shkallë, për fëmijët, vendoset baza për të nxënë sistematik ndërsa procesi edukativo-arsimor përqendrohet në:

- njohjen dhe të kuptuarit e të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësi të fëmijëve në familje, klasë, në shkollë dhe në komunitet;
- përvetësimin e elementeve themelore të shkrim-leximit në gjuhën amtare dhe të veprimeve me numra;
- mësimin fillestar të gjuhës angleze;
- hulumtimin/njohjen-eksplorimin e mjedisit në mënyrë më sistematike;
- përmbushjen e detyrave të caktuara, duke respektuar afatet e përcaktuara kohore;
- pjesëmarrjen individuale, dhe si pjesë e një grupi, gjatë përvojave të ndryshme të të nxëniet.

Shkalla 2 - Përforcim dhe zhvillim

Kjo shkallë përfshin klasat III, IV dhe V. Në këtë shkallë nxënësit duhet të përkrahen për të konsoliduar të arriturat themelore në lexim, shkrim, komunikim dhe teknika të të nxëni, si bazë për zhvillim të mëtejshëm.

Në këtë shkallë fëmijët u nënshtrohen sfidave si në vijim:

- përdorimit të drejtë të gjuhës amtare dhe të gjuhës angleze në komunikim verbal dhe me shkrim;
- përdorimit të drejtë të simboleve dhe operacioneve;
- shpalosjes së fushave të reja të dijes dhe thellimit të informacioneve;
- zhvillimit të aftësi për të menduar, për të strukturuar dhe për të orientuar zgjidhjen e problemeve;
- të kuptuarit e përgjegjësisë për vetveten, për të tjerët dhe për mjedisin;
- zgjerimi të burimeve të informacionit;
- kultivimit të pavarësisë vetjake në planifikimin dhe realizimin e detyrave;
- ndërlidhjes së dijes teorike me problemet praktike;
- zhvillimit të qëndrimit pozitiv ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve;
- zhvillimit të qasjes kritike të zgjidhjes së problemeve.

Shkalla 3 - Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim

Kjo shkallë përfshin klasat VI dhe VII. Gjatë kësaj etape synohet thellimi i njohurive/dijeve në kuadër të fushave kurrikulare, duke siguruar një bazë fillestare për orientim akademik, profesional dhe në karrierë. Në këtë shkallë nxënësit përballen me sfidat për:

- zhvillimin e të menduarit abstrakt dhe kompleks (p.sh. shkathtësi të larta intelektuale), që është i nevojshëm për të njohur botën dhe veten si dhe për zgjidhje të problemeve;
- kultivimin e interesimit për njohje më të thellë të vetes, të tjerëve dhe mjedisit natyror e shoqëror;
- zhvillimin e shkathtësi për vetëvlerësim;
- zhvillimin e shkathtësi për komunikim efektiv, përfshirë edhe kodet matematikore dhe

shkencore;

- zgjerimin e mundësive për komunikim verbal dhe të shkruar në gjuhën e tyre amtare, në gjuhën angleze dhe në gjuhën e dytë të huaj apo në një të tjetër nga gjuhët e mjedisit;
- zhvillimin e përgjegjshmërisë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe për mbrojtje të mjedisit.

Shkalla 4 - Përforsim dhe orientim

Kjo shkallë përfshin klasat VIII dhe IX. Gjatë kësaj shkalle synohet që nxënësit të orientohen në karrierë duke i pasur parasysh mundësitë e ndryshme. Ata ballafaqohen me sfida që kanë të bëjnë me:

- shfrytëzimin e burimeve të informacionit dhe qasjes kritike ndaj të dhënave të ndryshme;
- zhvillimin e interesit për jetën publike nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë në aktivitete të ndryshme jashtëshkollore;
- çështje të ndryshme që lidhen me tema nga jeta reale përmes projekteve që do t'u mundësojnë konsolidimin e dijeve të tyre dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive dhe qëndrimeve;
- mundësitë e ndryshme të studimit dhe orientimit në karrierë;
- përgatitjen praktike dhe aktivitetet orientuese që u mundësojnë të qartësojnë aspiratat e tyre;
- përforsimin e shkathtësive të vetëvlerësimit;
- përforsimin e shkathtësive për punë të pavarur individuale dhe ekipore.

Shkalla 5 - Arsim i përgjithshëm dhe arsim profesional

Kjo shkallë përfshinë klasat X dhe XI. Në këtë shkallë nxënësit përgatiten që të ballafaqohen me studime më të thella dhe më të specializuara të nxënies, në kuptim të përgatitjes akademike për arsim të lartë dhe/apo për të hyrë në tregun e punës. Ballafaqime me këto sfida nxënësve u mundëson:

- zhvillimin e vetëbesimit;
- studimin më të thelluar dhe më të specializuar, duke përdorur aftësitë për shfrytëzim të burimeve të ndryshme, me një qasje kritike ndaj të dhënave;
- zhvillimin e dëshirës, përkushtimit dhe këmbënguljes, për arritje më të larta, në mësim, karrierë, jetë personale, profesionale dhe publike;
- përgatitjen për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, për të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore si qytetarë të përgjegjshëm dhe kompetentë dhe për të garuar me sukses në tregun e punës;
- zhvillimin si individë dhe anëtarë të shoqërisë, të aftë dhe me kapacitete të nevojshme për jetë dhe punë që të përballin ndryshimet e ekonomisë lokale dhe globale dhe të mësojnë të aftësohen se si të bëjnë zgjidhjen e problemeve në situata të ndryshme në jetën personale dhe profesionale;

- përgatitjen për jetë të pavarur, për përballjen me sfida dhe mundësi që ofron shoqëria bashkëkohore, për të ndërmarrë veprime dhe vendime të përgjegjshme të bazuar në informata të sakta për situata që dalin gjatë jetës.

Shkalla 6 – Konsolidim dhe specializim

Kjo shkallë përfshin klasën XII. Kjo është fazë e kalimit nga adoleshenca në pjekuri, gjatë së cilës nxënësit duhet të konsolidojnë përvojën e përgjithshme të shkollimit të detyrueshëm dhe të përgatiten për kërkesat e një faze të re të jetës dhe arsimimit të lartë. Nxënësit me programet mësimore në shkollat e mesme të larta do të përgatiten për t'u futur në tregun e punës si punëtorë të shkathët. Gjatë kësaj shkalle ata/ato do t'u ekspozohen sfidave për:

- demonstrimin e aftësive për identifikimin e burimeve të domosdoshme dhe për t'iu qasur në mënyrë kritike të dhënave të ndryshme;
- demonstrimin e aftësisë për vendimmarrje të pavarur, për marrjen e përgjegjësive për zgjedhjet dhe për veprimet personale;
- demonstrimin e përkushtimit të tyre për angazhim të vazhdueshëm për të nxënë, për studim të mëtutjeshëm dhe/apo për zhvillim profesional;
- demonstrimin e shkathtësive për të zhvilluar dhe për të promovuar strategji për planifikimin e karrierës nëpërmjet kërkimit të shembujve dhe inovacioneve, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e idesë së ndërmarrësisë;
- demonstrimin e shkathtësive për ndryshimin e konceptit të karrierës, nëpërmjet kërkimit të një spektri më të gjerë të punëve, duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive të transferueshme për mundësitë e karrierës në të ardhmen;
- angazhimin në procesin e planifikimit të karrierës personale nëpërmjet hulumtimit lidhur me mundësitë e kualifikimit pas sekondar, duke pasur në konsideratë se qëndrimet dhe nevojat për punë dhe vendimmarrje do të ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme.

5. Fushat e Kurrikulës, lëndët dhe modulet mësimore

Kurrikula e Kosovës është strukturuar në shtatë fusha kurrikulare. Ato përbëjnë bazën për organizimin e procesit edukativo-arsimor në shkollë në nivele dhe shkallë përkatëse të kurrikulës. Fushat e kurrikulës janë grupe lëndësh të cilat në saje të profilit të tyre epistemologjik kanë rezultate dhe detyra të përbashkëta sa i përket mësimdhënies dhe nxënies në funksion të arrijtjes së kompetencave të parashikuara në KK. Për zhvillimin e gjithanshëm të kompetencave duhet të ketë një ndërlidhje ndërmjet fushave, lëndëve dhe moduleve të Kurrikulës.

Fushat e Kurrikulës janë:

- Gjuhët dhe komunikimi
- Artet
- Matematika
- Shkencat natyrore
- Shoqëria dhe mjedisi
- Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
- Jeta dhe puna

Fushat e kurrikulës përfshijnë një ose disa lëndë apo module mësimore. Lëndët dhe modulet duhet të ndjekin/realizojnë qëllimin dhe rezultatet e të nxënies të përcaktuara për fushën përkatëse të kurrikulës. Disa lëndë të një fushe të kurrikulës mund të mësohen si të integruara në shkallë të ndryshme të kurrikulës.

Për secilën fushë kurrikulare në dokumentet tjera kurrikulare përcaktohen rezultatet e të nxënies, të cilat do të mundësojnë arrijtjen e kompetencave.

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Tabela e fushave kurrikulare dhe lëndëve mësimore sipas niveleve dhe shkallëve të kurrikulës.

Fushat e Kurrikulës	Lëndët mësimore në shkallë kryesore të kurrikulës (Shk)								
	Edukimi Parashkollor	Shk 1	Shk 2	Shk 3	Shk 4	Shk 5		Shk 6	
	Grupmoshat: 0-3 vjeç 3-5 vjeç	Klasat: Përgatitore, I, II	Klasat III, IV dhe V	Klasat VI dhe VII	Klasat VIII dhe IX	Klasat X dhe XI (Arsimi i përgjithshëm)	Klasa X dhe XII (Arsimi dhe aftësimi profesional AAP) ³	Klasa XII (Arsimi i përgjithshëm)	Klasa XII (Arsimi dhe aftësimi profesional – AAP)
Gjuhët dhe komunikimi	Aktivitete që nxisin komunikimin gjuhësor	Gjuhë amtare Gjuhë angleze	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuha e dytë	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuha e dytë	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuha e dytë	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuha e dytë Gjuhë të tjera ⁴		Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuha e dytë Gjuhë të tjera ⁵	
Artet	Aktivitete që nxisin shkathtësitë e komunikimit dhe të shprehurit artistik	Edukatë figurative Edukatë muzikore	Edukatë figurative Edukatë muzikore	Edukatë figurative Edukatë muzikore	Edukatë figurative Edukatë muzikore	Edukatë figurative Edukatë muzikore		Edukatë figurative Edukatë muzikore	
Matematika	Aktivitete që nxisin gjykimin, shkathtësitë numerike	Matematikë	Matematikë	Matematikë	Matematikë	Matematikë		Matematikë	
Shkencat natyrore	Aktivitete që nxisin hetimin dhe zbulimin e mjedisit	Njeriu dhe natyra	Njeriu dhe natyra	Biologji Fizikë Kimi	Biologji Fizikë Kimi ⁶	Biologji Fizikë Kimi Gjeografi Astronomi		Biologji Fizikë Kimi Gjeografi Astronomi	
Shoqëria dhe mjedisi	Aktivitete që nxisin ndërgjegjësimin për veten dhe për të tjerët dhe zhvillimin e shkathtësive sociale	Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi	Edukatë qytetare Histori Gjeografi ⁷	Edukatë qytetare Histori Gjeografi	Histori Edukatë qytetare Sociologji Psikologji Filozofi		Histori Edukatë qytetare Sociologji Psikologji Filozofi dhe Logjikë	
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Aktivitete që nxisin zhvillimin e shkathtësive fizike dhe të shprehive të higjienës	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti		Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	
Jeta dhe puna	Aktivitete që nxisin kapacitetet për të kuptuar dhe për të ndjekur procedurat dhe rregullat, kërshërinë, kreativitetin dhe të nxënit në mënyra të ndryshme	Shkathtësi për jetë	Shkathtësi për jetë	Teknologji me TIK	Teknologji me TIK	TIK		TIK	

³ Lëndët mësimore për Arsimin Profesional përcaktohen në Kurrikulën Bërthamë të Arsimin Profesional

⁴ Gjuhët tjera zgjedhen nga nxënësit dhe varen nga mundësitë kadrovike

⁵ Gjuhët tjera zgjedhen nga nxënësit dhe varen nga mundësitë kadrovike

⁶ Mësimi realizohet në lëndë (fizikë, kimi, biologji) duke synuar qasjen integruese ndërlëndore.

⁷ Mësimi realizohet në lëndë (edukatë qytetare, histori, gjeografi) duke synuar qasjen integruese ndërlëndore.

Gjuhët dhe komunikimi

Fusha **Gjuhët dhe komunikimi** u mundëson nxënësve që të zhvillojnë dhe të kultivojnë përdorimin e gjuhës si mjet komunikimi në jetën e përditshme, në jetën profesionale dhe në jetën publike. Nëpërmjet kësaj fushe kurrikulare, secila lëndë duhet t'i arrijë të gjitha kompetencat kryesore të përcaktuara në Kurrikulë.

Kjo fushë kurrikulare përfshin lëndët: gjuhë amtare, gjuhë e parë e huaj (gjuha angleze), gjuhë e dytë (e huaj ose mjedisit) si dhe gjuhë të tjera.

Secila lëndë mësimore në kuadër të kësaj fushe përfshin edhe letërsinë, si pjesë e përdorimit të gjuhës në raport me vlerat estetike.

Gjuha amtare, mësohet nëpër të gjitha shkallët e kurrikulës, që nga klasa përgatitore e deri në klasën XII.

Gjuha angleze fillon nga shkalla e parë dhe mësohet deri në klasën e fundit të shkollës së mesme të lartë. Në shkallën e parë kjo gjuhë mësohet kryesisht nëpërmjet lojës, vizatimeve dhe këngëve, për të vazhduar me leximin dhe shkrimin në shkallët e tjera të Kurrikulës. Gjuha angleze, në nivelin e shkollës së mesme të lartë, në dy shkallët e fundit të kurrikulës, do të mësohet si lëndë e aplikuar në funksion të drejtimeve dhe profileve të arsimit profesional.

Gjuha shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare mësohet që nga shkalla e dytë e Kurrikulës.

Gjuha e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa e gjashtë). Si gjuhë e dytë mund të jetë: njëra nga gjuhët e huaja si gjuha gjermane, gjuha frënge, gjuha italiane etj. dhe/ose gjuhët e mjedisit (gjuha serbe, boshnjake, turke) sipas zgjedhjes së lirë të nxënësve.

Gjuhët e tjera fillojnë në shkallën e pestë të Kurrikulës, d.m.th. në shkollën e mesme të lartë (gjimnaze dhe shkolla profesionale), si pjesë e kurrikulës me zgjedhje. Në këtë grup mund të përfshihen gjuha latine, gjuha e vjetër greke apo ndonjë gjuhë tjetër. Këto lëndë mund të mësohen si të obligueshme në gjimnazet e specializuara dhe në shkollat profesionale, varësisht nga drejtimet dhe profilet e caktuara.

Artet

Fusha e arteve luan rol të rëndësishëm në zhvillimin intelektual, emocional, social dhe kulturor të nxënësve. Kjo fushë, ndihmon në formimin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve, për të shprehur përvojat e tyre personale, për të kuptuar e kultivuar talentin e tyre krijues si dhe për të përvetësuar konceptet e duhura në vizatim, pikturë, skulpturë, grafikë, dizajn, vallëzim, interpretim dhe muzikë. Përmes arteve nxënësit zhvillojnë shkathtësitë e tyre artistike. Ata aftësohen që të përdorin teknika e burime të ndryshme, të komunikojnë, të interpretojnë, respektivisht të aftësohen për t'u shprehur dhe për të dhënë kontribut në zhvillimin artistik në shoqëri.

Fusha mësimore e arteve është pjesë përbërëse e procesit të të mësuarit dhe e ndihmon lidhjen midis imagjinatës dhe inteligjencës së fëmijëve në veprimtari të ndryshme krijuese.

Qëllimi i kësaj fushe është zhvillimi i imagjinatës krijuese, të figuracionit dhe muzikalitetit, reagimit ndaj shprehjes artistike, e cila konsiston në shumëllojshmërinë e veprimtarive që përfshihen në edukimin artistik.

Pjesëmarrja e nxënësve në të gjitha format e të shprehurit artistik mundëson zhvillimin e identitetit individual, por në të njëjtën kohë zhvillon edhe identitetet e tyre grupore. Gjithashtu diversiteti kulturor, në njërën anë, dhe trashëgimia kulturore kombëtare, në anën tjetër, duhet të jenë pjesë integrale të mësimit në arte.

Matematika

Matematika në Kurrikulë përfaqësohet si fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore. Ajo mundëson zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe sistematike, nxitjen e kërkimit dhe inkurajimit për zbulim, ndërtimin e njohurive të reja me qëllim të zbatimit dhe integritetit të tyre në fushat e tjera dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Matematika mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës. Në shkallën e parë dhe të dytë bëhet një lidhje e njohurive për numrat, figurat gjeometrike, pozitën në hapësirë, matjet dhe shkathtësitë për llogaritje e zgjidhje të problemeve. Në shkallën e tretë dhe të katërt kjo lidhje integrohet me njohuritë nga algjebra, gjeometria dhe statistika, kurse në shkallën e pestë dhe të gjashtë sigurohet një zgjerim dhe thellim i njohurive edhe nga trigonometria, analiza matematike dhe probabiliteti.

Një nga aspektet më të rëndësishme në të gjitha shkallët është integrimi i matematikës me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare me qëllim të zotërimit të kompetencave kryesore. Në shkallën e pestë dhe të gjashtë, matematika është në funksion të përgatitjes së nxënësve për studime të mëtejme dhe, në rastin e shkollave profesionale, përfshirja e matematikës së aplikuar mundëson aftësimin e nxënësve për profesione të caktuara.

Nëpërmjet mësimit të matematikës, nxënësit do të jenë në gjendje të kuptojnë rolin e të menduarit matematik për zhvillimin e shkencës e të teknologjisë moderne, si dhe rëndësinë e zbatimit të matematikës në situatat e zgjidhjes së problemeve të llojeve të ndryshme.

Shkencat natyrore

Shkencat natyrore u mundësojnë nxënësve për të njohur, për të kuptuar, për të hulumtuar natyrën, botën e gjallë e jo të gjallë dhe njeriun, duke filluar nga mikrokozmosi deri në makrokozmos.

Shkencat natyrore përfaqësojnë fushën kurrikulare që nxënësve u ofron mundësi të zhvillojnë të kuptuarit e koncepteve, të teorive dhe të ligjshmërive dhe dukurive fundamentale të natyrës. Ato kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, ndihmojnë në ngritjen e nivelit teknologjik dhe të zhvillimit ekonomik, rritjen e cilësisë së jetës së njeriut, ruajtjen e shëndetit, mjedisit jetësor dhe mirëqenies.

Shkencat natyrore nxënësve u mundësojnë të zhvillojnë kureshtjen për hulumtim shkencor të mjedisit natyror dhe të ndryshimeve të shkaktuara nga njeriu.

Ata do të aftësohen që t'i zotërojnë fillet e punës shkencore, konceptet, mjetet dhe procedurat, të nxjerrin përfundime të sakta nga analiza e të dhënave, t'i prezantojnë dhe t'i vlerësojnë rezultatet.

Nxënësit do të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve duke përdorur mjete matëse, në punë individuale dhe ekipore në kuadër të realizimit të programit mësimor apo ndonjë projekti. Në këtë mënyrë ata do të zhvillojnë mendimin kritik dhe do të aftësohen për identifikimin e problemeve, parashtrimin e pyetjeve, formulimin e hipotezave dhe nxjerrjen e përfundimeve të bazuara në argumente, duke ndjekur hapat e metodologjisë shkencore.

Në Shk 1 dhe Shk 2 nxënësit do të mësojnë për mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, metodat hulumtuese për studimin e proceseve dhe të dukurive natyrore.

Në Shk 3 dhe Shk 4 mësimi realizohet në lëndë mësimore (fizikë, kimi, biologji) duke synuar qasjen integruese ndërlëndore

Në Shk 5 dhe Shk 6, në shkollat e përgjithshme (në gjimnaze), shkencat natyrore zhvillohen në lëndë të veçanta (fizikë, kimi, biologji dhe astronomi (vetëm në Shk 6). Në shkollat profesionale mësimi i shkencave natyrore rregullohet me kurrikulën bërthamë të arsimit profesional.

Shoqëria dhe mjedisi

Përmes fushës **Shoqëria dhe mjedisi** nxënësit zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe prirjet që janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike. Kjo ndihmon që të zhvillojnë të kuptuarit e tyre mbi botën, njerëzit, vlerat e tyre, proceset shoqërore në kohë, vende dhe rrethana të ndryshme. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj fushe ata zhvillojnë edhe të kuptuarit e tyre për mjedisin e vet dhe më gjerë. Kjo do t'u mundësojë atyre që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive e kritike, në komunitetin lokal, kombëtar e global, në të cilin jetojnë e angazhohen, për çështjet shoqërore dhe mjedisore.

Orientimet e ndryshme dhe qasjet tematike të kësaj fushe do të përqendrohen nga perspektiva e arritjes së qëllimeve arsimore, siç janë kultivimi i identitetit personal, shoqëror, kombëtar, identiteti shtetëror e kulturor. Gjithashtu, kjo fushë kontribuon në, ndërtimin dhe ruajtjen e mirëqenies mendore, emocionale e shoqërore, në të mësuarit për të jetuar së bashku si dhe në edukimin për zhvillim të qëndrueshëm.

Në Shk 1 dhe Shk 2 mësohet për ndërgjegjësimin dhe marrjen e vendimeve, njohuritë mbi veten dhe shoqërinë dhe të kuptuarit e botës. Në Shk 3 dhe Shk 4 në kuadër të fushës Shoqëria dhe mjedisi trajtohen çështjet shoqërore dhe mjedisore, nëpërmjet mësimi të lëndor ose të integruar të lëndëve: Histori, Gjeografi dhe Edukatë qytetare

Në Shk 5 dhe Shk 6, në shkollat e përgjithshme (gjimnaze), Shoqëria dhe mjedisi realizohet nëpërmjet lëndëve të veçanta: Histori, Gjeografi, Edukatë qytetare, Sociologji, Psikologji, Filozofi dhe Logjikë, duke vënë theksin në zhvillimin e kompetencave përkatëse kryesore në mënyrë të baraspeshuar.

Në shkollat profesionale mësimi i fushës shoqëria dhe mjedisi rregullohet me kurrikulën bërthamë të arsimit profesional.

Edukata fizike, sportet dhe shëndeti

Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit në arsimin parauniversitar synon që të nxënësit të zhvillojë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme, të cilat sigurojnë mirëqenien e shëndetit të tyre fizik, mendor, emocional, social si dhe të ndihmojë në përballjen me sukses të sfidave të jetës.

Kjo fushë fillon të zbatohet në shkallën 1 të kurrikulës dhe është e pranishme deri në shkallën 6. Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit do të ofrojë një qasje të integruar të edukimit fizik dhe sporteve me edukatën shëndetësore. Aktivitetet e rregullta fizike dhe sportive ndihmojnë ndërtimin e një stili të jetës së shëndetshme e aktive dhe estetike.

Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit iu mundëson nxënësve, zbatimin në praktikë të njohurive teknike e taktike të fituara në disiplinat sportive; zbatimin e rregulloreve teknike të disiplinave sportive; kryerjen e kombinacioneve lëvizore me përmbajtje të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit lëvizor me dhe pa mjete, kryerjen e elementeve të thjeshta akrobatike; zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë të ushtruarit me aktivitet fizik e sportiv; njohjen dhe respektimin e dhënies së ndihmës së parë në raste të traumave që ndodhin gjatë aktivitetit fizik; zbatimin në jetën e përditshme të parimeve të Olimpizmit, Filozofisë Olimpike dhe Fair-Play-t.

Nëpërmjet aktivitetit fizik e sportiv, nxënësve u krijohet mundësia të marrin pjesë në një shumëllojshmëri veprimtarish fizike e sportive, individualisht dhe në grup, të kuptojnë rëndësinë e të ushtruarit sistematik, të edukohen për disiplinë, vullnet, vetëvlerësim dhe për konkurrencën. Gjithashtu, kjo fushë i ndihmon nxënësit të vlerësojnë sportin si alternativë karriere në të ardhmen.

Përmes kësaj fushe nxënësit do të edukohen për marrjen e ushqimit të shëndetshëm që nënkupton kompetencë të mjaftueshme për nutricionin.

Jeta dhe puna

Fusha e Kurrikulës **Jeta dhe puna** ofron aktivitete sfiduese, të cilat përfshijnë hulumtimin, zgjidhjen e problemeve, shqyrtimin e koncepteve dhe të nxënësve, që rezultojnë nga krijimi i produkteve të cilat kanë zbatim praktik. Nxënësve do të zhvillojnë kreativitetin e tyre dhe shkathtësi ndërmarrëse dhe do të inkurajohen për të qenë dizajnerë inovativë dhe kreativë të së ardhmes. Këto attribute janë thelbësore, kur kemi parasysh se në të ardhmen nxënësve do të luajnë rol të madh në ekonominë globale (për të qenë konkurrentë në tregun e punës) duke përfshirë zhvillimet tekniko-teknologjike të shekullit XXI. konform parimeve mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Qëllimi kryesor i të nxënësve në fushën Jeta dhe puna është që të aftësojë nxënësve të jenë të informuar, të shkathët, mendimtarë, qytetarë të adaptueshëm dhe ndërmarrës.

Aktivitetet mësimore të kësaj fushe do të realizohen në të gjitha shkallët e kurrikulës, duke bërë që kompetencat e pritura të arrihen gradualisht.

Kjo fushë kurrikulare përfshinë: Shkathtësitë për jetë, Punëdore, Ekonomi shtëpiake, Këshillimin dhe orientimin në karrierë, Teknologjinë dhe TIK-un, Edukimin për punë në profesion dhe ndërmarrësi, Edukim për zhvillimin e qëndrueshëm.

Në nivelin 0 (mosha 0-5) fusha jeta dhe puna realizohet përmes aktiviteteve punëdore - shkathtësi për jetë. Në Shk 1 dhe Shk 2, kjo fushë përqendrohet në shkathtësitë për jetë që nënkupton punëdore, ekonomi shtëpiake si dhe elemente të edukimit në karrierë.

Në Shk 1 dhe Shk 2 mësohet për njohjen, të kuptuarit, zgjidhjen e problemeve përmes demonstrimit praktik dhe realizohen përmes lëndës mësimore Shkathtësi për jetë.

Në Shk 3 dhe Shk 4, kjo fushë përqendrohet në koncepte apo module të teknologjisë, TIK-ut. Këshillim dhe orientim në karrierë. Ndërmarrësi si dhe Edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm, të cilat realizohen përmes lëndës mësimore Teknologji me TIK.

Në Shk 5 dhe Shk 6 - për gjimnaze kjo fushë përfshin konceptet apo modulet e TIK-ut, këshillimin dhe orientimin në karrierë, ndërmarrësi dhe edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm. Këto koncepte realizohen përmes lëndës së TIK-ut. Në Shk 5 dhe Shk 6 të shkollat profesionale kjo fushë përfshin konceptet apo modulet e TIK-ut dhe Edukimi në profesion (modulet teoriko-praktike profesionale), Këshillim dhe orientim në karrierë, ndërmarrësi, dhe Edukim për zhvillimin e qëndrueshëm, ndërsa realizohen përmes lëndëve TIK, Teoria dhe praktika në profesion (varësisht nga profili arsimor).

Në shkollat profesionale, fusha **Jeta dhe puna** përfshin një pjesë më të madhe të fondit të orëve, ku së bashku me pjesën zgjedhore të kurrikulës, bëjnë 60% të kohës së flokuar (ndarë) dhe ajo kryesisht i dedikohet profilit përkatës profesional.

6. Kurrikula me bazë shkolle-mësimi me zgjedhje dhe aktivitetet tjera

Si mësimi përmes fushave kurrikulare ashtu edhe mësimi përmes kurrikulës me bazë shkolle (mësimi me zgjedhje dhe aktivitetet tjera) kanë një të përbashkët, të dyja duhet të ndihmojnë nxënësit në arritjen e kompetencave kryesore të përcaktuara me këtë kornizë. Mësimi me zgjedhje sikurse edhe mësimi që ofrohet përmes fushave kurrikulare është i detyrueshëm për të gjithë nxënësit, përveçse mësimi me zgjedhje ofrohet nga shkolla në bazë të interesimit të nxënësve, nevojave të komunitetit, sugjerimeve që ofron MASHT-i, dhe mundësive të vet shkollës.

Krahas mësimit të detyrueshëm kurrikula me bazë shkolle ofron edhe aktivitete tjera që kontribuojnë në arritjen e kompetencave nga nxënësit dhe njëkohësisht në performancën e shkollës. Me aktivitete tjera nënkuptohet mësimi plotësues, shtues, mësimi ekstrakurrikular/ jashtëkurrikular (aktivitete sportive, puna me projekte, aktivitete artistike, etj.)

Procedurat për organizimin e kurrikulës me bazë shkolle rregullohen me dokumenta tjera kurrikulare dhe me akte nënligjore.

7. Plani mësimor

Plani mësimor ndahet për fusha kurrikulare në mënyrë të baraspeshuar, duke pasur parasysh moshën e nxënësve dhe nevojat e tyre zhvillimore. Koha e përcaktuar në këtë plan mësimor nënkupton minimumin e kohës për secilën fushë të kurrikulës. Në dokumentet tjera kurrikulare do të paraqiten planet mësimore të detajuara.

Plani mësimor sipas shkallëve kryesore të kurrikulës

Fushat e Kurrikulës	KSNA 0	KSNA 1		KSNA 2		KSNA 3				
	Shk 1		Shk 2	Shk 3	Shk 4	Shk 5 & 6				
	Klasa përgatitore	Klasa 1 & 2				Gjimnazi Shoqëror – gjuhësor	Gjimnazi i shkencave natyrore	Gjimnazi i specializuar ⁸	Arsimi dhe aftësimi profesional ⁹	
Gjuhët dhe komunikimi	Nxënësit gjatë javës kalojnë në të gjitha fushat kurrikulare		38.10	33.80	27.12	25	30	23.33		
Artet			9.52	8.45	6.78	6.67	5.56	2.22		
Matematika			23.81	21.13	13.56	13.33	8.89	13.33		
Shkencat natyrore			4.76	8.45	16.95	20	11.11	35.56		
Shoqëria dhe mjedisi			4.76	8.45	16.95	16.67	25.56	6.67		
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti			9.52	8.45	6.78	6.67	6.67	6.67		
Jeta dhe puna			4.76	4.23	6.78	6.67	5.56	5.56		
Pjesa zgjedhore			4.76	7.04	5.08	5	6.67	6.67		
Aktivitete jashtëkurrikulare										

⁸ Plani mësimor për gjimnazet e specializuar, përcaktohet nga MASHT, varësisht nga tipi i gjimnazit të specializuar.

⁹ Plani mësimor për arsimin dhe aftësimin profesional, përcaktohet nga MASHT, varësisht nga profilet e arsimit dhe aftësimin profesional.

8. Sistemi i vlerësimit të nxënësve

Me Kornizën e Kurrikulës përcaktohen qëllimet, parimet dhe llojet e vlerësimit që sigurojnë ndërlidhjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit të vlerësimit. Sistemi i vlerësimit definon se *çka* vlerësohet, *kur vlerësohet*, *si* dhe *nga kush* realizohen llojet e ndryshme të vlerësimit të nxënësve.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është mbështetja e të nxënësve të nxënësve. Përmes sistemit të vlerësimit të nxënësve të përcaktuar me KK kërkohet të sigurohen informacione të vazhdueshme për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve, përshtatshmërinë e kurrikulës dhe përmirësimin e shkollës. Mbi bazën e këtyre informacioneve merren vendime dhe planifikohen veprime në përkrahje të nxënësve për zotërim të kompetencave dhe përmirësim e avancim të procesit të vlerësimit në përgjithësi.

Vlerësimi i nxënësve bazohet në rezultatet e të nxënësve për kompetenca, fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore të përcaktuara me dokumentet kurrikulare si më poshtë:

Dokumentet kurrikulare	Rezultatet e të nxënësve
KORNIZA KURRIKULARE E KOSOVËS	Rezultatet e të nxënësve të kompetencave në përfundim të arsimit parauniversitar.
KURRIKULAT BËRTHAMË I,II,III	Rezultatet e të nxënësve për kompetenca dhe fusha kurrikulare për secilën shkallë kurrikulare.
PLANET E PROGRAMET LËNDORE	Rezultatet e të nxënësve sipas lëndëve (për secilën klasë, duke filluar nga klasa përgatitore-deri në klasën e 12-të)

Parimet e vlerësimit

Vlerësimi bazohet në këto parime:

Vlefshmëria. Vlerësimi duhet të sigurojë se kërkesat dhe kriteret e vlerësimit të jenë të lidhura me rezultatet e të nxënësve për klasën dhe shkallën e kurrikulës, të përdoren matje dhe burime të shumta për të dhënë gjykime dhe se vlerësimi mbulon shtrirjen dhe thellësinë e programit mësimor.

Transparenca. Vlerësimi duhet të sigurojë se kriteret, metodat dhe procedurat e vlerësimit janë të njohura për nxënës dhe për të gjithë akterët e përfshirë në procesin e vlerësimit. Informacioni për nxënës, lidhur me rezultatet e arritura, informatat kthyesë dhe mundësitë e përparimit të jetë i qartë, i saktë dhe të jepet me kohë.

Besueshmëria. Vlerësimi duhet të sigurojë se gjykimet për përparimin e nxënësve bazohen në instrumente, lloje të ndryshme të vlerësimit dhe burime të ndryshme të informacionit. Në këtë proces ofrohen dëshmi për të argumentuar cilësinë e vlerësimit dhe për t'u siguruar se nëse përsëritet vlerësimi atëherë rezultatet do të jenë të njëjta.

Paanshmëria. Vlerësimi duhet të sigurojë se respektohen kërkesat e kodit etik të vlerësimit, respektohen procedurat e vlerësimit ndaj çdo nxënësi apo grupi të nxënësve, përdoren instrumente të ndryshme të vlerësimit që i mundësojnë secilit nxënës të shfaqë performancën e tij/saj dhe ofrohet mbështetja e duhur në të nxënit e nxënësve drejt zotërimit të kompetencave.

Llojet e vlerësimeve

- Korniza Kurrikulare përcakton dy lloje të vlerësimit:
- Vlerësimi i brendshëm
- Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel shkolle/klase nga mësimdhënësit e shkollës dhe sipas përshkrimit të procedurave e kriterëve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore.

Vlerësimi i brendshëm bëhet për disa qëllime, si për përparimin dhe arritjen në të nxënë, për planifikim të punës me nxënës, për identifikimin e prirjeve dhe talenteve të nxënësve, etj.

Vlerësimi i brendshëm duhet t'u mundësojë të gjithë nxënësve të shprehin njohuritë e reja dhe të tregojnë nivelin e zotërimit të kompetencave duke përfshirë:

- Gjerësinë dhe thellësinë e tyre;
- Gatishmërinë për t'iu përgjigjur sfidave të nivelit të përcaktuar me rezultatet e të nxënit;
- Aftësinë për t'i zbatuar ato në situata dhe rrethana të reja.

Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm duhet të jetë mbështetja e të nxënit të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave dhe kjo arrihet më së miri nga kombinimi i vlerësimit formativ (për nxënie) dhe vlerësimit përmbledhës (i të nxënit).

Llojet e vlerësimit të brendshëm

Korniza Kurrikulare përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm:

- Vlerësimi i **vazhdueshëm**
- Vlerësimi **përfundimtar**
- Vlerësimi **për shkallë**³

Korniza përcakton periudhën e realizimit të secilit lloj të vlerësimit, bartësit/përgjegjësit e vlerësimit, qëllimet kryesore dhe mënyrat e dokumentimit/evidentimit të arritjeve të nxënësve. Këto aspekte pasqyrohen në tabelën në vijim.

³ Në përfundimin e një shkalle të kurrikulës (klasa II, V, VII, IX, XI dhe XII) bëhet vlerësimi i nivelit të arritjes së njohurive dhe zotërimit të kompetencave nga nxënësi sipas përcaktimit në kurrikulën bërthamë të nivelit përkatës të arsimit.

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Llojet e vlerësimit dhe periudha e realizimit	Bartësit	Qëllimet kryesore sipas llojeve të vlerësimit	Dokumentimi/ evidentimi i arritjeve në vlerësim
Vlerësim i vazhdueshëm - Bëhet gjatë procesit të të nxënësve (vlerësimi formativ), dhe - Në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike apo periudhe të mësimimit (vlerësimi përmbledhës)	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse	Mbështetja e të nxënësve të nxënësve Informimi dhe raportimi Vendosja e notës në fund të periudhave të caktuara mësimore	Evidencimi në notesin e punës së mësimdhënësit Evidencimi në libër të klasës i notave për periudhat e caktuara të vitit mësimor/ dhe apo ditarin elektronik Portfolio e nxënësit
Vlerësim përfundimtar Bëhet në fund të vitit mësimor/ vitit shkollor.	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse .	Vendosja e notës përfundimtare në fund të vitit mësimor/ shkollor ¹⁰ Informimi dhe raportimi Planifikimi për mbështetjen e të nxënësve të nxënësve në vitin vijues	Notat përfundimtare evidencohen në librin e klasës dhe në librin amë/ dhe/apo në ditarin elektronik. Në arsimin bazik (klasën përgatitore, klasat I deri IX), notat përfundimtare evidencohen në librezën e nxënësit. Në arsimin e mesëm të lartë notat përfundimtare evidencohen në dëftesë (në fund të klasëve X, XI dhe XII).
Vlerësim për shkallë Në fund të çdo shkalle kurrikulare përkatësisht në fund të klasave II, V, VII, IX, XI, XII ¹¹	Ekipi/aktivi i mësimdhënësit të cilët kanë realizuar programin mësimor brenda një shkalle kurrikulare ¹²	Verifikimi i nivelit të arritjes së rezultateve të të nxënësve dhe zotërimi i kompetencave kryesore në nivel të një shkalle dhe fushe kurrikulare. Planifikimi për mbështetjen e të nxënësve të nxënësve në vitin vijues Informim dhe raportim për prindërit dhe për institucionet (MASHT-in etj.) Diplomimi në shkollën e mesme të lartë (arsimin e përgjithshëm dhe atë profesional)	Evidencimi përshkruar në librin e klasës – në faqet e veçanta për vlerësimin përmblyllës në fund të çdo shkalle të kurrikulës ¹³ . Në raportet përmbledhëse të aktiveve profesionale dhe këshillave të klasës Në klasën XII në diplomë të arsimit të përgjithshëm dhe në diplomë të profesionit

¹⁰ Nota përfundimtare e një lënde mësimore reflekton nivelin e performancës së nxënësit gjatë një viti shkollor. Nota përfundimtare formohet me mesataren aritmetike të notave të vlerësimit të vazhdueshëm për periudhat e caktuara mësimore. Përveç notave të vlerësimit në periudhat e caktuara mësimore, merret për bazë edhe progresi dhe përparimi i nxënësit nga periudha mësimore në periudhën tjetër, bazuar në dëshmitë tjera që ka mësimdhënësi.

¹¹ Është vlerësimi i standardizuar dhe bëhet në dy mënyra: (a) Me teste të përgatitura nga DVSM-ja dhe të menaxhuara nga shkolla, dhe (b) Me teste të përgatitura dhe të menaxhuara nga DVSM-ja ose ndonjë institucion tjetër i përcaktuar nga MASHT-i. Rezultatet e këtij vlerësimi analizohen në nivel shkolle dhe krahasohen me evidencat e vëna në dispozicion nga mësimdhënësit që e mbulojnë fushën kurrikulare për të dëshmuar progresin e secilit nxënës, secilës klasë dhe shkollës në përgjithësi. Evidencat duhet të jenë të dokumentuara në portfoliot e nxënësve dhe të prezantohen edhe në raportin vjetor të shkollës.

¹² Vlerësimi i brendshëm për shkallë organizohet me bazë në shkollë dhe administrohet nga kryesuesit e organeve profesionale të shkollës së kurrikulës si dhe përkrahet nga Drejtoritë Komunale të Arsimit.

¹³ Përshkrimi i vlerësimit në fund të shkallës mbështetet në evidencat dhe në mestaren e arritjeve në testin standardizuar. Përshkrimi i vlerësimit përmbledhet me njërin nga shkallët e vlerësimit – varësisht nga niveli i arritjes së rezultateve të nxënësve për fusha të kurrikulës dhe zotërimi të kometicave: Performancë minimale në rezultatet e të nxënësve (D), Performancë e mirë në rezultatet e të nxënësve (C), Performancë shumë e mirë në rezultatet e të nxënësve (B), Performancë e shkëlqyeshme në rezultatet e të nxënësve (A).

Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i jashtëm është vlerësim i standardizuar për të matur nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënësve, zotërimin e kompetencave në fund të nivelit I, II dhe III të arsimit parauniversitar. Ky vlerësim organizohet nga autoriteti qendror për vlerësim i autorizuar nga MASHT. Me kërkesë të MASHT-it vlerësimi i jashtëm mund të bëhet edhe për qëllime të tjera nga institucione tjera relevante.

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet për qëllime:

- inspektimi dhe verifikimi të cilësisë së vlerësimit në nivel klase, shkolle dhe komune.
- hulumtimi dhe zhvillimi
- vendimmarrjeje e politikë-bërjeje në fusha të ndryshme të arsimit.

Korniza Kurrikulare përcakton tri vlerësime të standardizuara shtetërore në fund të niveleve formale të arsimit të cilat realizohen për qëllime të ndryshme:

Vlerësimet e standardizuara shtetërore	Qëllimet e vlerësimit	Dokumentimi/ evidentimi
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës V	Hulumtimi për aspekte të ndryshme të arsimit dhe identifikim i nevojave për mbështetje të nxënësve në shkollën e mesme të ulët dhe përmirësimin e nivelit fillor	Certifika në fund të klasës V
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës IX	Matja e nivelit të arritjes së kompetencave dhe orientimi për regjistrim në shkollën e mesme të lartë	Certifika në fund të klasës IX
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës XII <i>Provimi i Maturës Shtetërore</i>	Matja e nivelit të arritjes së kompetencave dhe certifikimi për mundësi vazhdimi në studime të larta universitare. Nxënësi me arritje të pikëve të caktuara për kalueshmëri në provimin e maturës merr certifikatë të provimit të maturës.	Certifikata e Maturës Shtetërore

Vlerësimet e standardizuara shtetërore janë të përqendruara në matjen e nivelit të zotërimin të kompetencave kryesore të parashikuara në kurrikulë për secilin nivel të arsimit⁴.

⁴ Detaje shtesë për vlerësimet e standardizuara shtetërore ofrohen në kurrikulat bërthamë për tri nivelet e arsimit, në Ligjin e Maturës dhe në Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e nxënësve.

9. Dokumentet që dalin nga Korniza Kurrikulare

Përveç KK-së, për ta zbërthyer më tutje kurrikulën hartohen edhe dokumente të tjera kurrikulare, si në vijim:

Kurrikula Bërthamë për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (lindje–5 vjeç, për grupmoshat 0–3 dhe 3–5),

Kurrikula Bërthamë për Arsimin Fillor,

Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët,

Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë – gjimnaze,

Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë - shkolla profesionale.

Planet dhe programet lëndore nga klasa përgatitore deri në kl. XII, duke mbuluar të gjitha fushat /lëndët mësimore për secilën klasë.

Për ta ndihmuar zbatimin e kurrikulës, në nivel shkolle, është e nevojshme të hartohen materiale të ndryshme, si tekste shkollore, materiale plotësuese të mësimdhënies dhe nxënies, si dhe materiale didaktike e instrumente për vlerësim.

Kurrikulat bërthamë

Kurrikulat bërthamë janë dokumente që rregullojnë organizimin dhe zbatimin e kurrikulës brenda niveleve të arsimit parauniversitar. Ato bazohen në dispozitat ligjore të vendosura nga MASHT-i dhe janë obliguese për gjithë nxënësit e Republikës së Kosovës.

Këto dokumente janë të strukturuar në bazë të rezultateve të të nxënit për kompetenca dhe për fusha kurrikulare në nivel shkalle kurrikulare.

Derisa rezultatet e të nxënit sipas fushave të kurrikulës mundësojnë integrimin dhe qasjen e tërësishme në mësimdhënien e lëndëve të veçanta brenda një fushe të kurrikulës, rezultatet e të nxënit për kompetenca promovojnë integrim të mëtejshëm të fushave të kurrikulës në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me kornizën e kurrikulës. Ato shprehin pritjet e *mësimdhënësve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë* në raport me arritjet konkrete, të matshme, të nxënësve në fund të çdo shkalle të kurrikulës.

Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të kurrikulës

Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore shprehin kërkesat esenciale të arritshmërisë drejt zotërimit të kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të një shkalle të caktuar të kurrikulës. Ato paraqesin një pasqyrë të qartë të asaj që nxënësit domosdoshmërisht duhet të dinë, të jenë në gjendje të shprehin dhe të bëjnë pas përfundimit të një shkalle të kurrikulës.

Rezultatet e të nxënit për kompetenca të kurrikulës parashihen të arrihen nga të gjithë nxënësit me rastin e përfundimit të një shkalle të kurrikulës, nuk mbulojnë gjithçka që nxënësit kanë

mësuar apo është dashur të mësojnë gjatë një shkalle të caktuar.

Në Kurrikulën Bërthamë për shkollat e mesme të larta përcaktohen rezultatet për kompetenca të të nxëniet, të përbashkëta për të gjithë nxënësit të cilët vijojnë nivelin e mesëm të lartë. Ndërsa rezultatet e të nxëniet sipas fushave të kurrikulës për gjimnaze dhe për shkolla profesionale do të përcaktohen në bazë të specifikave të këtyre dy nënsektorëve të arsimit të mesëm të lartë.

Rezultatet e të nxëniet sipas fushave të kurrikulës

Rezultatet e të nxëniet sipas fushave të kurrikulës janë pritje që duhet të arrihen nga nxënësit në fund të çdo shkalle kurrikulare. Përmes tyre synohet të sigurohet lidhshmëria ndërmjet lëndëve dhe aktiviteteve mësimore, që realizohen në kuadër të një fushe të kurrikulës me qëllim të integritit të njohurive përkatëse (deklarative dhe procedurale), shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të ofruara përmes atyre lëndëve dhe në përgjithësi inkurajimin e mësimin të integruar; të zhvillohet një sistemi i përbashkët i *përvojave mësimore* të ndërlidhura, që u ofrohen nxënësve me qëllim të arritjes të "kompetencave kryesore për shekullin XXI", siç janë përcaktuar nga KK-ja; të sigurohet një platformë për zhvillimin e planeve dhe programeve lëndore; të zbatohen praktika të reja të mësimdhënies në nivel shkolle, duke mundësuar zhvillimin e planeve dhe programeve me bazë shkolle.

Komponentët e tjerë të Kurrikulës Bërthamë

Aspekte të tjera që rregullohen me Kurrikulën Bërthamë përfshijnë:

- Fushëveprimin e fushave të Kurrikulës nëpër shkallë të Kurrikulës;
- Udhëzimet metodike për organizimin e procesit edukativ-arsimor në kuadër të secilës fushë të Kurrikulës gjatë shkallëve të Kurrikulës;
- Planet mësimore që përcaktojnë shpërndarjen e fondit të orëve për fushat e kurrikulës gjatë shkallëve të kurrikulës dhe klasave;
- Kriteret dhe format e vlerësimit dhe
- Rekomandimet për menaxhimin e Kurrikulës në nivel shkolle.

Kurrikulat lëndore

Kurrikulat lëndore përgatiten në harmoni me dispozitat e përcaktuara me kurrikulën bërthamë.

Kurrikulat lëndore përmbajnë:

- Rezultatet e të nxëniet që nxënësit duhet t'i arrijnë në kuadër të secilës lëndë dhe temat mësimore përgjatë një klase/viti shkollor;
- Temat mësimore të lëndëve përkatëse për secilën klasë duke pasur parasysh kohezionin horizontal dhe vërtikal, aktualitetin, zhvillimin shkencor, mundësitë dhe interesat e nxënësve;

- Udhëzimet metodike për realizimin e temave mësimore në kuadër të lëndës përkatëse, arritjes së kompetencave dhe vlerësimit të nxënësve;
- Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare.
- Materialet didaktike dhe burimet e mjetet mësimore.

Hartimi i materialeve mësimore për mësimdhënie dhe nxënie

Nga perspektiva e punës me nxënësin në qendër dhe e punës së bazuar në kompetenca, është e rëndësishme që burimet mësimore t'i motivojnë nxënësit dhe të stimulojnë progresin e tyre. Megjithatë tekstet shkollore janë burime të vlefshme të të nxënit, qasja e nxënësve në informacione nuk kufizohet vetëm në ato. Qasja në burime mësimore dhe përdorimi i një spektri më të gjerë të tyre do të evitojë të nxënit rutinor e memorizues të nxënësve dhe do të ofrojë mundësi të të mësuarit për të nxënë.

Kurrikula e re u mundëson mësimdhënësve të shfrytëzojnë burime mësimore të cilat inkurajojnë dhe promovojnë përvetësimin e dijeve relevante, zhvillimin e shkathtësive, të vlerave dhe qëndrimeve të cilat shpien drejt zotërimit gradual të kompetencave kryesore, si:

- Tekste mësimore të lëndëve të ndryshme në kuadër të një fushe kurrikulare;
- Materiale të krijuara nga vetë mësimdhënësit dhe nxënësit për tematika dhe njësi të ndryshme;
- Burime nga faqe të ndryshme të internetit;
- Platforma të mësimit elektronik;
- Biblioteka elektronike;
- Burime të ndryshme nga jeta e përditshme (katalogë, udhëzues, burime njerëzore etj.).

Pavarësisht formatit dhe qëllimit (p.sh. softuerë arsimorë, pako eksperimentale apo tjetër), burimet mësimore duhet të hartohen në harmoni me parimet themelore të KK-së, duke mundësuar:

- mësimdhënie dhe nxënie që në mënyrë të balancuar siguron përvetësimin e dijeve, zhvillimin e shkathtësive dhe qëndrimeve intelektuale;
- zbatimin e metodave interaktive të mësimdhënies dhe nxënies, procedura të vlerësimit, të cilat ndihmojnë zhvillimin e kreativitetit dhe zgjidhjen e pavarur të problemeve;
- promovimin e vlerave pozitive, parimeve dhe përvojave, si: të drejtat e njeriut, drejtësinë sociale dhe gjithëpërfshirjen;
- shmangien e paragjykimeve dhe stereotipave, qëndrimeve diskriminuese, urrejtjes dhe dhunës;
- aktivitete relevante dhe të përshtatshme për vlerësim dhe vetëvlerësim, si dhe aktivitete të cilat përkrahin zhvillimin e kompetencës për të mësuar;
- ndërlidhjen me lëndët dhe fushat kurrikulare nëpër shkallë/nivele të kurrikulës.

Shkollat me komunitetin në përshtatshmëri me kërkesat e kurrikulës inkurajohen të vendosin *qendra të burimeve mësimore*, ku nxënësit udhëzohen nga mësimitdhënësit për identifikimin e burimeve të përshtatshme dhe shfrytëzimin e pavarur të tyre.

Mësimitdhënësit shfrytëzojnë qendrat e burimeve mësimore për të përgatitur materiale dhe për të pasuruar metodat e tyre mësimore.

Mësimitdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit inkurajohen që të angazhohen në mënyrë aktive në *hartimin e materialeve të përshtatshme* mësimore në përputhshmëri me kërkesat mësimore dhe interesat e nxënësve⁵. Nxënësit, mësimitdhënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit bashkëpunojnë edhe në krijimin e materialeve elektronike, për të nxënë përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

Për nxënësit me vështirësi në të nxënë, përgatiten materiale të përshtatshme dhe të individualizuara mësimore, sipas nevojave individuale të tyre.

⁵ Rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme. Mësimitdhënësit mund të zhvillojnë dosje (portfolio, pako materiale) për tema të ndryshme, duke shfrytëzuar gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës.

**ZBATIMI I KORNIZËS
KURRIKULARE**

2

Sigurimi i një mjedisi të favorshëm në shkollë për zbatimin e kurrikulës

Për t`u zbatuar kurrikula e re kërkon angazhim të të gjithë stafit të shkollës dhe akterëve tjerë të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi janë të ndërlidhur me punën e shkollës si në vijim:

Palët kryesore në procesin mësimor	Mundësitë e reja / kërkesat e kurrikulës
Nxënësi	<p>Njihet me rezultatet e të nxënit.</p> <p>Ndjek progresin e arritur, duke e krahasuar me nivelin e pritshmërisë dhe bën vetëvlerësim të vazhdueshëm.</p> <p>Është pjesëmarrës i vendimeve të rëndësishme për organizimin e punës në shkollë që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve si dhe me mbarëvajtjen e përgjithshme të punës në shkollë.</p>
Mësimdhënësi	<p>Përdor një varg metodash, përshtatur kontekstit, nevojave, interesimeve dhe mundësive të nxënësve.</p> <p>Përzgjedh përmbajtje relevante për nxënësit dhe planifikon proces të integruar mësimor, duke marrë në konsideratë lidhjen mes lëndëve dhe fushave të kurrikulës.</p> <p>Inkurajon nxënësit që të zgjerojnë horizontin e tyre dhe që të jenë më të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e ndryshme në jetë, në mësim dhe në punë.</p> <p>Kujdeset që të integrojnë çështjet dhe përvojat mësimore të cilat kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kryesore.</p> <p>Bën planifikimin e programeve mësimore, dhe aktiviteteve të tjera, përzgjedh dhe përgatit materiale të ndryshme mësimore.</p> <p>Identifikon problemet, vështirësitë, por edhe afinitetet e nxënësve në të nxënë dhe siguron mbështetjen e individualizuar të nxënësve</p> <p>Organizon mësim plotësues dhe shtues në bazë të vlerësimit të rezultateve të arritjes së nxënësve. Bën vlerësimin për të nxënit me qëllim që t`u ofrojë nxënësve në mënyrë të vazhdueshme informata kthyesë mbi progresin/ngecjet si dhe jep udhëzime, i motivon dhe i mbështet për punë të mëtejme.</p> <p>Bashkëpunon me prindërit për të siguruar angazhimin e nevojshëm për nxitjen e përparimit të nxënësve.</p> <p>Angazhohet në punë ekipore dhe bashkëpunon me aktivin profesional për planifikim, për këmbimin e përvojave në procesin e të nxënit, për vlerësimin e progresit të vazhdueshëm të nxënësve dhe të arritjeve gjatë vitit shkollor, në fund të klasës dhe shkallëve të kurrikulës.</p>

<p>Shërbimi profesional i shkollës (shërbimi pedagogjik, psikologjik, social etj.)</p>	<p>Mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme performancën e personelit edukativ, identifikon nevojat për përkrahje dhe siguron mbështetjen e nevojshme profesionale.</p> <p>Siguron bashkëpunimin e nevojshëm ndërmjet mësimeve dhe planifikimin e përbashkët të përvojave të të nxënësve.</p> <p>Këshillon personelin menaxhues të shkollës për planifikimin e angazhimit të mësimeve.</p> <p>Identifikon nevojat për angazhimin e ekspertëve të jashtëm në shkollë.</p> <p>Identifikon mundësitë për shfrytëzimin e shërbimeve të tjera publike në funksion të realizimit sa më efektiv të kurrikulës së re.</p> <p>Evidenton në mënyrë të vazhdueshme progresin e shkollës drejt zbatimit të kurrikulës, sfidat dhe zgjidhjet e bëra në nivel shkollë.</p> <p>Organizon procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve me rastin e përfundimit të shkollës të kurrikulës dhe në bashkëpunim me personelin mësues planifikon programet mbështetëse (mësimin plotësues dhe shtues) në nivel shkollë.</p> <p>Administron procesin e shkëmbimit të përvojave ndërmjet shkollave.</p> <p>Në bashkëpunim me mësuesit identifikon nevojat dhe vështirësitë e nxënësve në fushën e nxënies, në fushën emocionale dhe i përkrah ata.</p>
<p>Drejtori i shkollës</p>	<p>Siguron që shkolla të jetë një mjedis mësues miqësor, i sigurt dhe i këndshëm për nxënësit.</p> <p>Siguron ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së arsimit në shkollë dhe llogaridhënies së mësimeve.</p> <p>Siguron që kultura e përgjithshme e shkollës dhe atmosfera në klasë të kontribuojnë në kultivimin e vlerave dhe qëndrimeve të përcaktuara me kurrikulën bërthamë.</p> <p>Siguron mundësitë për mësime të diferencuara si në kuadër të aktiviteteve kurrikulare ashtu edhe të atyre jashtëkurrikulare</p> <p>Administron në mënyrë efektive fleksibilitetin dhe autonominë për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës në përputhje me kushtet specifike të personelit mësues, infrastrukturës së shkollës dhe specifikave të lokalitetit në të cilin vepron shkolla.</p> <p>Punon, në bashkëpunim me palët e interesit, drejt zhvillimit të një koncepti të qartë për shkollën, përfshirë vizionin dhe misionin e shkollës e po ashtu edhe mënyrat se si parasheh shkolla të përmirësojë cilësinë, barazinë dhe llogaridhënien mbi cilësinë e shërbimeve arsimore.</p> <p>Angazhohet për shkëmbimin e përvojave të mira, përballimin e sfidave dhe për gjetjen e zgjidhjeve për problemet e evidentuara gjatë procesit të zbatimit të kurrikulës.</p> <p>Mundëson bashkëpunimin e shkollës me shërbimet e tjera të fëmijëve në mënyrë që të përkrahen nxënësit për të kapërcyer vështirësitë në të nxënë dhe pengesat e nxënësve për vijimin e shkollës.</p> <p>Siguron respektimin e parimeve të demokracisë së shkollës, përfshirja e nxënësve, prindërve dhe bartësve të tjerë të arsimit në vendimmarrje në nivel të klasës dhe të shkollës.</p> <p>Siguron që rregullat dhe procedurat e funksionimit të shkollës të jenë të qarta dhe transparente.</p> <p>Siguron respektimin e llogaridhënies ndaj palëve të interesuara, komunitetit dhe autoriteteve të arsimit.</p>

Këshilli i nxënësve	Reflekton mbi performancën e përgjithshme të shkollës dhe mësimdhënësve, mjedisin shkollor dhe çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve; trajton shqetësimet, kërkesat dhe rekomandimet e nxënësve me Këshillin Drejtues, drejtorin e shkollës dhe autoritetet lokale të arsimit.
Këshilli i prindërve	Monitoron mjedisin shkollor si dhe performancën e përgjithshme të shkollës dhe të mësimdhënësve; trajton shqetësimet, kërkesat dhe rekomandimet e prindërve me Këshillin e Shkollës dhe autoritetet lokale të arsimit.
Këshilli drejtues i shkollës	Miraton në nivel shkollor planet dhe programet e zhvilluara me bazë shkollor dhe i përcjell tutje për shqyrtim dhe miratim nga autoritetet arsimore. Shqyrton dhe miraton planifikimet vjetore mësimore të përgatitura në nivel shkollor. Miraton aktivitetet jashtëkurrikulare. Shqyrton dhe miraton propozimet e shkollës për shfrytëzimin e pjesës zgjedhore të kurrikulës dhe aktivitetet jashtëkurrikulare. Shqyrton dhe miraton listën e teksteve shkollorë dhe materialeve të tjera. Ushtron funksione të ndërlidhura me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës. Vendos rendin shtëpiak të shkollës.

Zbatimin e kurrikulës shkolla duhet ta parashohë edhe në planin zhvillimor të shkollës. Shkolla duhet të ketë parasysh pasqyrën aktuale të situatës me fokus në:

- Pasqyrën aktuale të situatës në shkollë
- Infrastrukturën e shkollës
- Kuadrin mësimor
- Shërbimin profesional të shkollës
- Kuadrin drejtues
- Materialet didaktike

Mbi bazën e gjendjes së evidentuar shkolla bën planifikimin e masave (planin e zhvillimit) për të siguruar ngritjen e kapacitetit të shkollës në nivelin e domosdoshëm për të përmbushur kërkesat e kurrikulës.

FJALORTHI

KONCEPTI	SHPJEGIMI	KONCEPTET EKUIVALENTE
Aftësitë për jetë	Aftësitë për jetë janë aftësi psiko-sociale, për sjellje adaptive dhe pozitive që u mundësojnë individëve për t'u marrë në mënyrë efektive me kërkesat dhe sfidat e jetës së përditshme. Ato grupohen në tri kategori të gjera të aftësive: aftësitë njohëse për analizimin dhe përdorimin e informacionit, aftësitë personale për të menaxhuar dhe udhëhequr veten, dhe aftësitë ndërpersonale për të komunikuar dhe ndërvepruar në mënyrë efektive me të tjerët.	
Aktivitetet përmirësuese	Mundësi dhe përvoja mësimore që ofrohen me qëllim të sigurimit të ndihmës për nxënësit që të tejkalojnë vështirësitë në të nxënë në mënyrë efektive.	
Aktivitetet ekstra-kurrikulare	Aktivitete të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të lëndëve dhe fushave mësimore formale, por që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave	Aktivitetet jashtëkurrikulare
Arsim	Veprimtari themelore e institucioneve arsimore që siguron krijimin dhe shndërrimin e njohurive; përsosjen e kompetencave gjatë gjithë jetës; zhvillimin vetjak; zhvillimin dhe shndërrimin e kulturës. Rezultat i nxënies së qëllimshme, të planifikuar dhe të organizuar në mënyrë formale dhe joformale.	
Arsimi dhe aftësimi profesional	Arsimi dhe aftësimi për t'iu mundësuar nxënësve që të fitojnë shkathtësi për punë dhe kualifikime profesionale për profesione të caktuara, përveç arritjes së kompetencave kryesore të përcaktuara përmes kornizës së kurrikulës.	
Arsimi i detyrueshëm	Arsimi i detyrueshëm në Kosovë është i rregulluar me ligj, përfshin arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (KSNA 1 dhe 2).	
Arsimi fillor	Niveli i parë i arsimit prej pesë vitesh kohëzgjatje. Ky nivel përfshin edhe klasën përgatitore që e zgjatë ciklin në gjashtë vite (KSNA 1).	

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Arsimi formal	Arsim i qëllimshëm, i institucionalizuar, i planifikuar, i strukturuar në mënyrë hierarkike, që fillon me arsimin parashkollor dhe vazhdon deri në arsimin pasuniversitar. Rezultatet dhe kualifikimet e fituara në arsimin formal njihen me certifikata dhe diploma.	
Arsimi gjithëpërfshirës	Arsimi gjithëpërfshirës është proces që adreson dhe u përgjigjet nevojave të ndryshme të të gjithë nxënësve, përmes rritjes së pjesëmarrjes në të nxënë dhe duke reduktuar përjashtimin në të dhe përmes tij.	
Arsimi informal	Përvetësimi dhe zhvillimi i dijeve, shkathtësive dhe qëndrimeve jashtë mjediseve arsimore formale ose joformale gjatë përvojave të përditshme në mënyrë josistematike dhe të paplanifikuara.	
Arsimi joformal	Çfarëdo aktiviteti i organizuar dhe i qëndrueshëm që nuk korrespondon saktësisht me përkufizimin e arsimin formal. Prandaj arsimi joformal mund të mbahet brenda dhe jashtë institucioneve arsimore dhe iu shërben personave të të gjitha moshave. Programet e arsimin joformal nuk përcjellin detyrimisht sistemin e 'përshkallëzuar' dhe mund të jenë të ndryshme në kohëzgjatje. Për këtë lloj arsimimi mund të jepen ose të mos jepen certifikata për suksesin e arritur në mësim.	
Arsimi i mesëm i ulët	Niveli i parë i arsimin të mesëm (katërvjeçar në Kosovë) (KSNA 2).	
Arsimi i mesëm i lartë	Niveli i dytë i arsimin të mesëm (KSNA 3).	
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm:	Procesi i zhvillimit të njohurive të nxënësve, i të kuptuarit, i shkathtësive dhe attributeve të nevojshme për të punuar dhe jetuar në një mënyrë që mbron mirëqenien mjedisore, sociale dhe ekonomike, si në të tashmen dhe për brezat e ardhshëm.	
Autonomia e shkollës	E drejtë e garantuar që i jepet shkollës për të vendosur për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle, vlerësimin, menaxhimin e burimeve njerëzore në dispozicion të saj dhe për menaxhimin e burimeve financiare. Të gjitha këto ndërlidhen me llogaridhënien.	

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Burimi i të mësuarit	Referenca dhe përkrahje për mësimin e nxënësve, përfshirë tekstet shkollore, softverët arsimorë, vegla eksperimentale, atlase, fjalorë, ushtrimore, etj.	
Çështjet ndërkurrikulare	Përmbajtje e rëndësishme kurrikulare që nuk i përket krejtësisht vetëm një lënde apo fushe të kurrikulës ekskluzivisht mësimore, por që mësohet në disa lëndë. Shembuj të zakonshëm janë edukimi për paqe, të drejtat e njeriut dhe edukata qytetare, çështjet gjinore, shkathtësitë e komunikimit, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, edukimi ndërkulturor etj.	Temat të ndërlidhura
Dija	Tërësia e njohurive pak a shumë sistematike, të përvetësuara në një fushë të caktuar; gjithçka që dihet për botën që na rrethon.	
Ekonomi dhe shoqëri e dijes	Shoqëri dhe ekonomi në të cilën dija bëhet burimi kryesor i zhvillimit dhe përparimit.	
Edukimi për ndërmarrësi	Në kuptimin e ngushtë: pajisja e fëmijëve dhe të rinjve me shkathtësi ndërmarrëse siç janë iniciativa, vendim-marrja, ndërmarrja e riskut, udhëheqja, shkathtësi menaxheriale dhe organizative. Në kuptim më të gjerë: përgatitja e fëmijëve dhe të rinjve që të marrin role ndërmarrëse në ekonomi, d.m.th. të krijojnë bizneset/ ndërmarrjet e tyre.	
Edukimi shoku – shokun	Proceset e mësimin të bazuara në këmbimin e informatave, dijes dhe përvojave mes shokëve në të cilat ata veprojnë si persona burimorë lehtësues të mësimin dhe/ose mentorë.	Mësimi nga shokët
Fushë kurrikulare	Një bashkësi lëndësh që kanë qëllime dhe detyra të përbashkëta për zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave të nxënësit.	Fushë kurrikulare
Klasë bashkëvepruese	Mjedisi mësimor në nivel klase që bazohet në shkëmbime të vazhdueshme mes mësimdhënësve dhe nxënësve në kontekstin e aktiviteteve të bazuara në kërkim, zgjidhje të problemeve dhe punë konkrete.	

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kompetencë	Aftësi të gjera për t'i zbatuar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, rutinat, vlerat dhe emocionet në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse.	Harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.
Kompetencat kryesore	Kompetenca që konsiderohen nga sistemi i arsimit dhe aftësimi si të rëndësishme për të nxënëit e secilit individ të shoqërisë.	Kompetencat gjenerike, transversale apo gjithëpërfshirëse
Konceptet themelore	Konceptet themelore paraqesin tërësi kuptimore të cilat janë pjesë përbërëse të mendimeve. Konceptet përvetësohen dhe rrënjosen tek nxënësit gjatë tërë jetës. Konceptet i referohen një konteksti të caktuar dhe orientojnë përgatitjen e përmbajtjeve, rezultateve të të nxënëit dhe sigurojnë lidhjen ndërmjet lëndëve mësimore brenda një fushe kurrikulare.	
Korniza kurrikulare	Kornizë kurrikulare është dokumenti themelor në të cilin përshkruhen orientimet dhe udhëzimet kryesore për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar (qëllimet e arsimit, kompetencat kyçe, rezultatet e të nxënëit sipas niveleve etj.).	
Kurrikula	Përvoja e të nxënëit gjithëpërfshirës e planifikuar në bazë të qëllimeve, vlerave, iniciativave, burimeve dhe aktiviteteve në rregullimet formale dhe joformale.	
Kurrikula bërthamë	Kërkesat e përbashkëta për të gjithë nxënësit në aspektin e kompetencave kryesore, lëndët e përbashkëta dhe orientimet e përgjithshme.	
Kurrikula me bazë shkolle	Pjesa e kurrikulës që përgatitet dhe zbatohet në nivel shkolle.	
Kurrikula efektive	Ajo që nxënësit në të vërtetë e mësojnë në aspektin e dijes, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave.	Kurrikula e realizuar
Kurrikula formale	Mundësitë dhe përvojat mësimore që iu ofrohen nxënësve në kontekstin e arsimit formal. Kurrikula formale shërben si bazë për certifikata dhe dhënie të diplomave të pranueshme nga shoqëria.	Kurrikula e paraparë/zyrtare/e obliguar

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kurrikula e fshehur	Besimet, qëndrimet dhe shkathtësitë që nxënësit i kanë apo i zhvillojnë përmes përvojave të tyre personale. Kurrikula e fshehur mund të jetë ose të mos jetë në pajtueshmëri me kurrikulën zyrtare/të obligueshëm.	
Kurrikula me zgjedhje	Fusha mësimore/lëndët të cilat nxënësit mund t'i zgjedhin në pajtueshmëri me interesat, talentet dhe nevojat e tyre. Pjesa zgjedhore e kurrikulës që përfaqëson lëndët dhe aktivitetet kurrikulare të vendosura në nivelin e shkollës.	Kurrikula me bazë shkolle
Lënda	Degë e dijes e organizuar në mënyrë të qëllimshme, si një disiplinë e veçantë e të nxënësit që mësohet në një ose disa nivele arsimore dhe krijon kushte për ndërtimin e njohurive të reja dhe kompetencave kyçe nga nxënësit	
Lëndë bartëse	Një lëndë që duke u bazuar në fushëveprimin dhe strukturën e saj është më afër të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të caktuara të mësimin dhe mundëson zhvillimin e kompetencave të caktuara tek nxënësit.	
Llogaridhënia	Koncepti i qeverisjes etike (duke përfshirë qeverisjen etike të shkollës) që bazohet në njohjen dhe marrjen e përgjegjësisë për vendimet, veprimet dhe pasojat e tyre dhe ndërlidhet me pritjet për dhënien e llogarisë para palëve me interes.	
Metodologjia e vlerësimit	Strategjitë dhe aktivitetet e zbatuara, zakonisht nga mësimdhënësit (në vlerësimin e brendshëm) apo nga agjenci të specializuara (në vlerësimin e jashtëm), për të matur arritshmërinë ose performancën e nxënësit.	
Mësimdhënie	Proces i planifikimit, i organizimit dhe i udhëheqjes së situatave të të nxënësit (formale ose joformale) nga mësuesi duke përdorur një gamë të gjerë metodash që ju përshtaten stileve të nxënësve të nxënësve.	
Mësimdhënia në bllok	Mënyrë fleksibile për caktimin e orëve të mësimin duke përcaktuar periudha më kompakte të kohës për lëndët/njësitë mësimore.	

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Mësimdhënia e diferencuar	Mësimdhënia e diferencuar nënkupton krijimin e programeve dhe materiale të shumëfishta ashtu që nxënësit me aftësi, interesa apo nevoja të ndryshme mësimore të përjetojnë në mënyrë të barabartë rrugët e duhura për të absorbuar, përdorur, zhvilluar dhe prezantuar konceptet si pjesë e procesit mësimor të përditshëm. Lu mundëson nxënësve të marrin përgjegjësi më të madhe dhe pronësi mbi mësimin e tyre dhe ofron mundësi për mësimdhënien përmes shokut dhe nxënien në bashkëpunim.	
Mësimi elektronik	Mësimi që bazohet në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit me qëllim të avancimit të qasjes në informata, e po ashtu edhe përdorimi efektiv dhe i përgjegjshëm i tyre në kontekstin (e zakonshëm) të aktiviteteve në distancë dhe rrjet.	
Mësimdhënia e zgjeruar dhe koha për të mësuar	Ndarja e një kohe më të madhe për mësimdhënie dhe mësimnxënie të fituar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të caktuara me qëllim që të nxitet mësim i thellë dhe i qëndrueshëm.	
Mësimi holistik dhe i gjithanshëm	Mësimi që integron aspektet akademike me zhvillimin e nxënësve duke u përpjekur të trajtojë fenomenet si tërësi duke theksuar ndërlidhjen e dimensioneve dhe proceseve natyrore, shoqërore dhe personale.	Shiko po ashtu "Mësimin e integruar"
Mësimnxënia	Procesi i fitimit, absorbimit dhe zhvillimit të dijeve, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të reja janë të integruar në strukturat paraekzistuese, ndërsa gjithashtu përbëjnë një bazë për përvetësime të reja.	
Mësimdhënia e integruar dhe të mësuarit	Mësimi që reflekton dhe vë në pah lidhjet dhe ndërlidhjet në jetën individuale dhe shoqërore (aktivitetet njerëzore), natyrë dhe dije.	Mësimi holistik dhe i gjithanshëm
Mësimdhënia dhe mësimnxënia bashkëvepruese	Filozofia dhe praktika e përfshirjes së nxënësve për ta përcaktuar dhe ndërtuar përvojën e tyre mësimore duke marrë parasysh nevojat e tyre, interesat, dijen paraprake dhe kontekstin.	
Mësimi i bazuar në shërbim	Mësim që ndodh si rezultat i angazhimit të nxënësit në ofrimin e ndonjë shërbimi të organizuar, zakonisht në bashkësi lokale apo më gjerë.	Mësim i bazuar në shërbime për bashkësinë

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Mësimi domethënës	Për dallim nga mësimi përmendësh, shpie drejt zhvillimit të rrjetave konceptuale (d.m.th. hartave konceptuale) që mund të aplikohen në situata të ndryshme dhe që mundësojnë kreativitetin dhe zgjidhjen e problemeve. Në lidhje me pikëpamjet konstruktiviste, po ashtu i referohet mësimi që ka kuptim për nxënësit (d.m.th. është i ndërlidhur me përvojat e tyre personale dhe është i orientuar në praktikë dhe punë konkrete).	
Mësimi tërëjetësor	Pajisja e nxënësve me kompetencat e nevojshme për të qenë nxënës të suksesshëm gjatë tërë jetës.	
Mësimi i qëndrueshëm	Mësimi i ndërlidhur dhe në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë, ekonomisë dhe mjedisit.	
Mësimdhënia	Aktivitet që realizohet me qëllim të nxitjes së mësimi tek nxënësit duke përdorur një gamë të gjerë metodash që iu përshtaten stileve të mësimi të nxënësve.	
Mësimdhënia shoku-shokun	Praktika në të cilën nxënësit marrin rolin e mësimdhënësit në një mjedis shkollor me qëllim të ndarjes së dijes dhe shkathtësive të tyre me nxënësit tjerë.	
Mjedisi për mësimin holistik	Organizimi i mësimi që fton nxënësit të bëjnë përdorimin e njëkohshëm të aftësive intelektuale, emocionale dhe motorike të tyre.	
Mjedisi miqësor për fëmijët	Ambiente të të mësuarit të cilat janë miqësore, të bazuara në të drejta, gjithëpërfshirje dhe që janë të shëndetshme e mbrojtëse për të gjithë fëmijët.	
Mundësitë për nxënie	Situata dhe procese që sigurojnë kushtet dhe mjedisin për nxitjen e të mësuarit tek nxënësit.	
Ndarja e kohës	Koha e caktuar për mësimdhënie dhe nxënie e një lënde të veçantë apo fushe mësimore gjatë një viti dhe jave shkollore, kohën për realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare.	
Nxënës në qendër	Filozofia dhe praktika e organizimit të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit nga perspektiva e nevojave, interesave dhe aftësive të nxënësve.	

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja mësimore	Tërësia e dijeve, informacionit, fakteve, situatave, veprimtarive etj., të grupuara në një lëndë ose fushë të nxënësve, që shërbejnë si bazë për formimin dhe zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave.	Përmbajtja
Përvoja mësimore	Situatat dhe proceset përmes të cilave nxënësve i fitojnë/zhvillojnë dijet, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet.	
Programi mësimor	Dokument që përshkruan rezultatet dhe përmbajtjet mësimore, metodologjinë përkatëse për mësimdhënie dhe vlerësim, për një lëndë të veçantë.	Programi i mëimit në/për një lëndë të caktuar
Progresioni i mëimit të qëndrueshëm	Mësimi që bazohet në integrimin efektiv të mësimëve të mëparshme në sistemet e reja të dijës, shkathtësive dhe qëndrimeve.	
Qëndrimet	Pozicionimi i brendshëm drejt njerëzve, fakteve, fenomeneve, veprimeve, besimeve dhe situatave; gatishmëria e brendshme për të vepruar.	Gatishmëria
Rezultatet mësimore	Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijnë të besojnë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë nxënësve. Rezultatet janë shprehur në kornizën e kurrikulës në një varg domenesh, përfshirë dijen, të kuptuarit, shkathtësitë dhe kompetencat, vlerat dhe qëndrimet.	Rezultatet Kompetencat Arritjet
Sistemi i kurrikulës	Tërësia e dispozitave dhe dokumenteve të kurrikulës përmes të cilave u jipen udhëzime mësimdhënësve dhe palëve tjera për kurrikulën zyrtare dhe zbatimin e saj.	
Standardi	Nivel i arritjes apo suksesit që pritet të arrihet prej nxënësve.	
Struktura e kurrikulës	Mënyra se si është organizuar kurrikula.	
Shkallët kryesore të kurrikulës	Janë nën nivele formale të arsimit që ndërlidhen me fazat e zhvillimit të fëmijëve dhe organizimin e procesit të mësimdhënies, nxënies dhe vlerësimit.	
Shkathtësia	Aftësia për ta zbatuar dijen për të kryer një detyrë të veçantë sipas një standardi të qëndrueshëm (dimensioni operacional/procedural i dijës).	

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Vlerat	Atribute që njerëzit i çmojnë si parime udhëzuese dhe referenca kryesore për qëndrimet dhe sjelljet e tyre.	
Vetëvlerësimi	Vetëvlerësim i nxënësit për arritjet dhe vështirësitë e tij në mësim. Është vlerësimi që bën nxënësi për progresin e tij bazuar në njohuritë e reja dhe kompetencat.	
Vlerësimi	Procesi i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjyqimeve për arritshmërinë ose performancën e nxënësve.	
Vlerësim me bazë klase/ Vlerësimi nga mësimdhënësit	Vlerësimi që kryhet rregullisht nga mësimdhënësit në klasë si pjesë e aktiviteteve dhe strategjive të tyre të mësimit. Ofron informacion të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm sa i përket arritshmërisë së nxënësve dhe vështirësive në mësim.	
Vlerësimi diagnostikues	Vlerësim që identifikon nivelet e arritjeve të nxënësve, për të orientuar mësimin drejt plotësimit nevojave të tyre për nxënie.	
Vlerësimi formativ	Vlerësim që parimisht është i bazuar në klasë dhe realizohet nga mësimdhënësi me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të përparojnë në mësim gjatë tërë një periudhe të caktuar kohore. E parasheh mësimin si proces e jo vetëm si rezultat (<i>shiko po ashtu vlerësimin për nxënie</i>), me të cilin është i ndërlidhur.	
Vlerësimi i jashtëm	Vlerësim që kryhet nga agjenci të specializuara për vlerësim apo bazohet në procedurat dhe instrumentet e ofruara nga ato.	
Vlerësimi i nxënies	Mbledhja e dëshmive valide, të besueshme dhe krahasueshme për të vlerësuar progresin e nxënësve në nxënie (d.m.th. arritshmërinë e tyre në fusha të ndryshme të kurrikulës /lëndëve mësimore dhe zotërimin e kompetencave kryesore).	Vlerësimi përfundimtar
Vlerësimi për të nxënë	Vlerësim i kryer gjatë gjithë procesit mësimor me qëllim nxitjen e procesit të të nxënit. Ky vlerësim formues e sheh të nxënit si proces e jo vetëm si rezultat.	Vlerësimi formativ

Vlerësimi selektiv	Vlerësim që ka për qëllim grupimin e nxënësve në pajtim me kritere të caktuara të suksesit (p.sh. përzgjedhjen e nxënësve të talentuar për orët e shkencës ose arteve; përzgjedhjen e nxënësve që do të pranohen në shkolla të ndryshme të arsimit të mesëm të lartë).	
Vlerësimi sumativ	Vlerësimi që përmbledh përparimin dhe arritshmërinë e rezultateve mësimore nga/të nxënësit në një kohë të caktuar.	
Vlerësimi shoku-shokun	Vlerësimi i nxënësve për punën e nxënësve të tjerë (mund të jetë edhe formativ edhe sumativ).	
Vlerësimi parashikues	Vlerësimi që synon të parashikojë sukseset dhe vështirësit potenciale në zhvillimin e nxënësve me qëllim që të sugjerohen programe efektive për përparimin e tyre e po ashtu edhe veprime të duhura plotësuese në rast të mangësive (të pritura) në mësim.	
Zhvillimi i qëndrueshëm	Zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.	

Bibliografia

- Acedo, C., Ferrer, F. & Pamies, J. (2009). Inclusive education: Open debates and the road ahead. In *Prospects 151*, Vol. XXXIX, no. 3. pp. 227-238.
- Amstrong, Th. (1994). *Multiple Intelligences in the Classroom*. Alexandria: Virginia: Association for Supervision and Curriculum Development (ASCD).
- Anderson Robert, *The History of Scottish Education, pre-1980*, Scottish Education, Fourth Edition: Referndum, Edinburg University Press, 2013
- Australia. Department of Education, Science and Training & Australian National Training Authority. (2002). *Employability Skills for the Future*.
- Australia. Queensland Government. Department of Education, Training and The Arts. (2008). P12 Curriculum Framework. Incorporating Policies, Principles and Guidelines for Queensland State Schools.
- Botany, R., Magnin, Ch. & Zottos, e.(Eds.)(2005). *L'enseignement secondaire a l'échelle mondiale: bilans et perspectives. Actes du colloque de Genève 5-7 septembre 2004./Secondary Education eorldëide: Assessment and Perspectives. Proceedings of the Geneva Meeting 5-7 September 2004*. Geneva: DIP, SRED, UNESCO IBE & UNIGE/FAPSE.
- Brady, L. & Kennedy, K. (1999). *Curriculum construction*. Prentice Hill
- Braskavsky, C. & Benavot, A. (Eds.). (2006). *School Knowledge in Comparative and Historical Perspective. Changing Curricula in Primary and Secondary Education*. Comparative Education Research Centre, The University of Hong Kong & Springer.
- Braslavsky, C. (Ed.). (2006). *Textbooks and Quality Learning for All: Some Lessons Learned from International Experiences*. Geneva: UNESCO International Bureau of Education.
- Brock Colin and Alexiadou Nafsika, *Education around the world, A comperative introduction*, Bloomsbury, London and New York, 2013.
- Centre for Educational Policy Studies & Austria KulturKontakt.
- Colwill, I. & Gallagher, C. (2007). Developing a curriculum for the twenty-first century: the experiences of England and Northern Ireland. In *Prospects 144*, vol. XXXVIII, no. 4 (Open file: Curriculum Developers facing Education Reform Challenges). pp. 411-426.
- Conjard, P. & Devin, B. (Eds.). (2007). *La professionalisation: acquérir et transmettre des compétences*. Lyon: Anact.
- Core Curriculum for Primary, Secondary and Adult Education in Norway*. Norwegian Board of Education. (See <http://www.ls.no>).
- Council of Europe. (2004). *All European Study on EDC Policies*. Education for Democratic Citizenship Activities 2001-1004. Strasbourg.
- Crisan, A. (2006). *Current and Future Challenges in Curriculum Development: Policies, Practices and Networking for Change*. Bucharest: Editura Educatia 2000+ Humanitas Educational.
- Dale, R. & Robertson, S. (Eds.). (2009). *Globalisation and Europeanisation in Education*. Symposium books.
- Delors, J., Al Mufti, I. & Amagi, I. (Eds.). (1996). *Learning. The Treasure Within: Report to UNESCO of the International Commission on Education for the Twenty-first Century*. Paris:UNESCO.
- Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës. (2001). *Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës (Edukimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe i mesëm i lartë)*, libri i bardhë për diskutim. Prishtinë.
- Earl, L., Watson, N. & Katz, S. (2003). *Large-Scale Education Reform: Life Cycles and Implications*

for Sustainability. The Centre for British Teachers CfBT.

England Department for Education and Employment (DfEE) and Qualifications and Curriculum Authority (QCA). (1999). *The national curriculum, handbook for teachers* (pp. 10-13). London: HMSO.

England, QCA. (2007b). *A big picture of curriculum*. London. See http://7curriculum.qca.org.uk/key-stages-3-and-4/organizing-yourcurriculum/principles_of_curriculum_design/bigpicture.aspx.

England. Department for Education and Skills (DfES). (2000). *Schemes of work*. London. See www.standards.dfes.gov.uk/schemes3/.

England. QCA. (2000). *The revised national curriculum*. London. See www.qca.org.uk/qca_13575.aspx or www.net.

England. QCA. (2004). *The futures ebsite*. London. See www.qca.org.uk/qca_6073.aspx.

England. QCA. (2007a). *The neë secondary curriculum*. London. See www.crrriculum.qca.org.uk/aims/index.aspx.

Ettayebi, M., Jonnaert, Ph., Opertti, R., (Eds.) (2009). *Logique de compñtences et dñveloppement curriculaire: dñbats, perspectives et alternative*. Editions L'Harmattan.

European Commission. Directorate-General for Education and Culture. (2000). *European*

Fakulteti i Edukimit. (2010). *Hulumtimet në shkencat e edukimit nr.1 Vol 7*. Prishtinë

Farstad, H. (2004). *Competencies for Life: Some Implications for Education*. Background Paper to workshop 3: Quality Education and Competencies for Life. UNESCO 47th Session of the International Conference on Education.

Flinders, D. J. & Thornton, S. J. (Eds.). (2004). *The Curriculum Studies Reader*. (2nd edition). New York: Routledge.

Gardner, H. (1993). *Multiple Intelligences. The Theory into Practice. A Reader*. Basic Books.

Georgescu, D. & Palade, E.(2003). *Reshaping Education for an Open Society in Romania 1990-2000: Case Studies in Large-Scale Education Reform*. Vol. II, no 3. The world Bank.

Georgescu, D. (2002). On curriculum development in Kosovo. In *The Development Education Journal*. Vol. 9.1. pp. 29-20.

Georgescu, D. (2005). Le role de l'education dans les situations de post-conflit. Les experiences du Bureau International d'Education (BIE). In Aligisakis, M. (Ed.). (2005). *L'Europe et la sorite des conflits*. Geneve: EURYOPA Institut Europeen, University de Geneve.

Georgescu, d. (2006). *Curriculum Philosophies for the 21st Century: what is Old and what is*

Georgescu, D. (2007). Introduction to the Open File. In *Prospects 144*, vol. XXXVIII, no. 4. (Open file: Curriculum Developers facing Education Reform Challenges).

GTZ & BMZ. (2008). *Learning to Live Together. Design, monitoring and evaluation of education for life skills, citizenship, peace and human rights*.(in collaboration with UNESCO

Harland, J. et al. (2002). *Is the curriculum working?* London: NFER.

Higginess Peter and Lavery Alastair, *Sustainable Development Education*, Scottish Education, Fourth Edition: Referndum, Edinburg University Press, 2013

IBE).

Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve. (2005). *Edukimi Parashkollor*. Tiranë

Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve. (2005). *Kurrikula dhe Shkolla*. Tiranë

Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve. (2006). *Revista Pedagogjike*. Tiranë

- Instituti Pedagogjik i Kosovës (2010). Kërkime Pedagogjike (përmbledhje punimesh), Prishtinë. Karameta Pllumb, Arsimi i gjeneratës tjetër, SARA, Tiranë, 2014.
- Keating-Chetëynd, S. (Ed.), Brett, P., Mompoin-Gaillard, P. & Salema, M. H., (2009). *Hoë all* Kelly A.V., The curriculum, theory and practice, 6th edition, SAGE, Los Angeles, London, New Delhi, Singapore, Washington DC, 2009.
- MASHT (2002). Plani dhe Programi Mësimor 9. Prishtinë
- MASHT (2003). Plani dhe Programi Mësimor 1. Prishtinë
- MASHT (2003). Plani dhe Programi Mësimor 10. Prishtinë
- MASHT (2003). Plani dhe Programi Mësimor 6. Prishtinë
- MASHT (2004). Plani dhe Programi Mësimor 11. Prishtinë
- MASHT (2004). Plani dhe Programi Mësimor 2. Prishtinë
- MASHT (2004). Plani dhe Programi Mësimor 7. Prishtinë
- MASHT (2005). Plani dhe Programi Mësimor 12. Prishtinë
- MASHT (2005). Plani dhe Programi Mësimor 13. Prishtinë
- MASHT (2005). Plani dhe Programi Mësimor 3. Prishtinë
- MASHT (2005). Plani dhe Programi Mësimor 4. Prishtinë
- MASHT (2005). Plani dhe Programi Mësimor 5. Prishtinë
- MASHT (2005). Plani dhe Programi Mësimor 8. Prishtinë
- MASHT (2005). Plani dhe Programi Mësimor 9. Prishtinë
- Materials*. Paris: UNESCO. (authors: Georgescu, D. & Bernard, J.).
- McCormick, R. & Murphy, P. (2000). Curriculum. The case for a focus on learning. In Moon, B., Ben-Peretz, M. & Broën, S. (Eds.). (2000). *Routledge International Companion to Education*. London: Routledge. pp. 204-234.
- Morgan Nik, Qasja skoceze në reformën kurrikulare dhe në zbatim, Konferenca ndërkombëtare, Qasja e re kurrikulare sfidë e së ardhmes, Kumtesat, prezantimet dhe rekomandimet, MASHT, 2014.
- New Zealand. Ministry of Education. (Year not mentioned). *The Neë Zealand Curriculum Framework*. wellington. See http://ëëë.tki.org.nz/r/governance/nzcf/index_e.php
- New? In Crisan, A. (2006). Current and Future Challenges in Curriculum Development: Policies, Practices and Netëorking for Change. pp. 79-96. Bucharest: Editura Educatia 2000+ Humanitas Educational.
- Norëay. The Royal Ministry of Education, Research and Church Affairs. (Year not mentioned).
- Northern Ireland. (1999). Key messages from the Curriculum 21 conferences and the curriculum monitoring programme. Belfast.
- Northern Ireland. CCEA. (2007). *The neë Northern Ireland curriculum ëbsite*. See www.nicurriculum.org.uk. For Thematic Units, see www.nicurriculum.org.uk/connected_learning/thematic_untis/.
- Norway. The Royal Ministry of Education, Research and Church Affairs. (1999). *The Curriculum for the 10-Year Compulsory School in Norëay*. Norwegian Board of Education. (See <http://www.ls.no>).
- OECD. (2008). *Trends Shaping Education*. Centre for Educational Research and Innovation.
- OECD. (2009). *Education today: The OECD Perspective*. Centre for Educational Research and Innovation, Education & Skills.

- of competences. Strasbourg: Council of Europe Publishing.
of the working Committee on Quality Indicators.
- OSCE, ODIHR, Council of Europe, OHCHR & UNESCO. (2009). Human Rights Education in the School System of Europe, Central Asia and North America: A Compendium of Good Practice. (edited by Tibbitts, F.)
- Overview and Learning Area Statements. See www.dest.gov.au/sectors/school_education_initiatives_revie.
- Oxford English Mini Dictionary, Oxford University Press, 2013.
- Perry, L. B. & Tor, G. (2008). Understanding educational transfer: theoretical perspectives and conceptual frameworks. In *Prospects 148*, Vol. XXXVIII, no. 4. pp. 509-526.
- Piaget, J. (2005). *Mbi Pedagogjinë*. Tiranë: Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve
- Pinar, w. F. (Ed.). (2003). International Handbook of Curriculum Research. Routledge.
Practices Supported by Rigorous Evidence: A User Friendly Guide.
Prospects 151, Vol. XXXIX, no. 3. pp. 251-280.
- Report on the Quality of School Education. Sixteen Quality Indicators. Report based on the work.
- Ross, A. (1999). Curriculum. Construction and Critique. London & New York: Falmer Press.
- Rychen, D. s. & Tiana, A. (2004). Developing Key Competencies in Education. Some Lessons Learned from International Experience. Geneva: UNESCO International Bureau of Education.
- Sahlberg Pasi, Finnish lessons, publish by Teacher College, Columbia University, New York, 2011.
- Savolainen, H. (2009). Responding to diversity and striving for excellence: the case of Finland. In *Prospects 151*, Vol. XXXIX, no. 3. pp. 281-292.
- Schleicher, A. (2006). The Economics of Knowledge. Why Education is Key to Europe's Success. The Lisbon Council Policy Brief.
- Schleicher, A. (2009). Securing quality and equity in education: Lessons from PISA. In Scotland. Scottish Executive. (2006). A Curriculum for Excellence. Building the Curriculum 1. The contribution of Curriculum Areas. Edinburgh.
- Scotland. Scottish Qualification Authority. (2003). *Key competencies – some international comparisons*. Policy and Research Bulletin. Bulletin no. 2.
- Scotland. Smarter Scotland Scottish Government, HMIE – Improving Scottish Education, SQA & Learning Teaching Scotland. *Curriculum for Excellence*. Edinburgh. See www.curriculumforexcellencescotland.gov.uk.
- Scotland. The Scottish Government. (2008). Curriculum for Excellence. Building the Curriculum 3. A Framework for Learning and Teaching. Edinburgh.
- South Africa. (2005). Revised National Curriculum Statement Grades R-9 (Schools) Policy teachers can support citizenship and human rights education: a framework for the development The world Bank. (2005). Reshaping the Future. Education and Postconflict Reconstruction.
- U. S. Department of Education, Institute of Education Sciences, National Center for Education Evaluation and Regional Assistance. (2003). *Identifying and Implementing Educational*.
- UNESCO Global Monitoring Report 2005. (2004). *The Quality Imperative*. UNESCO Publishing.
- UNESCO Global Monitoring Report 2008. (2007). *Education for all by 2015. will we make it?*. UNESCO Publishing and Oxford University Press.

UNESCO, UNESCO IBE & ISESCO. (2008). Thinking and Building Peace through Innovative Textbook Design. Report of the Inter-regional Experts' Meeting on Developing Guidelines for Promoting Peace and Intercultural understanding through Curricula, Textbooks and Learning

UNESCO. (2005). Towards Knowledge Societies. Paris: UNESCO Publishing.

Washington, D. C.

Whitby, K., Filmer-Sankey, C. & S. O'Donnell, S. (2005). International Review of Curriculum and Assessment Frameworks. Thematic Probe: The Teaching of Skills in Lower Secondary Education. QCA & National Foundation for Educational Research (NFER). (See also INCA Education around the world supported by Qualifications and Curriculum Development Agency/QCDA and NFER - http://www.inca.org.uk/thematic_probes.html)

White, G. (2004). *Rethinking the School Curriculum. Values, Aims and Purposes*. London: Routledge Falmer.

William, D. (2000). Standards. What are they, what do they do and where do they live? In Moon, B., Ben-Peretz, M. & Brown, S. (Eds.). (2000). *Routledge International Companion to Education*. London: Routledge. pp. 351-363.

Zgaga, P. (2005). The Importance of Education in Social Reconstruction. Ljubljana & Wien:

Zhvillimi i arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë. (2008). *Sfidat dhe rezultatet (antologji)*. Prishtinë: Përkrahja finlandeze për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë

Kontribuesit që morën pjesë në rishikimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës

Udhëheqës të procesit për rishikim:

Kabineti i Ministrit, MASHT

Departamenti për zhvillimin e arsimit parauniversitar, MASHT

Divizionit për planprograme dhe tekste shkollore, MASHT

Falënderojmë për kontributin dhe mbështetjen gjatë këtij procesi:

Zyrtarët e MASHT

Hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës

Profesorët universitarë

Ekspertët nga Projekti i Binjakëzimit

Ekspertët nga GIZ CDBE

Ekspertët vendorë

Falënderim i veçantë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë falënderon të gjithë udhëheqësit e procesit dhe kontribuesit tjerë, vendorë e ndërkombëtarë, të cilët hartuan Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2011. Puna e tyre e rëndësishme shërbeu si bazë për rishikim të Kornizës Kurrikulare dhe përgatitjen e Kurrikulave Bërthamë, të cilat u pilotuan në 95 shkolla të Kosovës. Rishikimi dhe finalizimi i dokumenteve kurrikulare nuk do të ishte i mundur pa kontributin e tyre të çmueshëm.

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Lista e kontaktit

Lista e mëposhtme e kontaktit është paraqitur me qëllim që të jemi më afër përdoruesve të këtij materiali dhe të ofrojmë sqarime plotësuese e përgjigje në pyetjet eventuale, për dokumentin në tërësi apo për fusha të caktuara të kurrikulës.

Nr.1	Emri dhe mbiemri	Pozita	Fusha	Email adresa
1	Agim Bërdyna	Zv. Ministër	Aspektet e përgjithshme të KK	agim.berdyna@rks-gov.net
2	Alush Istogu	U.d. Sekretar i MASHT	Aspektet e përgjithshme të KK	alush.istogu@rks-gov.net
3	Osman Buleshkaj	Këshilltar i jashtëm për Kurrikula	Aspektet e përgjithshme të KK	obuleshkaj@gmail.com
4	Mustafë Kadriu	U.d. Drejtor i Departamentit për zhvillimin e arsimit parauniversitar	Aspektet e përgjithshme të KK	mustaf.kadriu@rks-gov.net
5	Shqipe Gashi	Koordinatore – KSNA 1	Aspektet e përgjithshme të KK	shqipe.z.gashi@rks-gov.net
6	Labëri Luzha	Zv. Koordinatore – KSNA 1	Aspektet e përgjithshme të KK	laberi.luzha@rks-gov.net
7	Ismet Potera	Koordinator – KSNA 2	Aspektet e përgjithshme të KK	ismet.poter@rks-gov.net
8	Shejnaze Elezi	Zv. Koordinatore – KSNA 2	Aspektet e përgjithshme të KK	shejnaze.elezi@rks-gov.net
9	Selim Mehmeti	Koordinator – KSNA 3	Aspektet e përgjithshme të KK	selim.mehmeti@rks-gov.net selimmehmeti@hotmail.com
10	Radica Berishaj	Zv. Koordinatore – KSNA 3	Aspektet e përgjithshme të KK	radica.berishaj@rks-gov.net
11	Feime Llapashtica-Lipscomb	Koordinatore	Gjuhët dhe komunikimi	feime.llapashtica@rks-gov.net
12	Nizafete Kutllovci-Bardhi	Zv. Koordinatore	Gjuhët dhe komunikimi	nizafete.bardhi@rks-gov.net
13	Besa Luzha	Koordinatore	Artet	besa.luzha@gmail.com
14	Haki Xhakli	Zv. Koordinator	Artet	hakixhakli@gmail.com
15	Mustafë Kadriu	Koordinator	Matematika	mustaf.kadriu@rks-gov.net
16	Fatmir Elezi	Zv. Koordinator	Matematika	fatmir.elezi@rks-gov.net
17	Rexhep Kastrati	Koordinator	Shkencat natyrore	rexhep.kastrati@rks-gov.net
18	Mirlinda Dehari-Zeka	Zv. Koordinatore	Shkencat natyrore	mirlinda.zeka@rks-gov.net
19	Igballe Cakaj	Anëtare	Shkencat natyrore	
20	Arbër Salihu	Koordinator	Shoqëria dhe mjedisi	arber.salihu@rks-gov.net
21	Besa Halimi-Zagragja	Zv. Koordinatore	Shoqëria dhe mjedisi	besa.h.zagragja@rks-gov.net
22	Lulavere Kadriu-Behluli	Koordinatore	Edukata fizike, sportet dhe 3shëndeti	lulavere.behluli@rks-gov.net

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

23	Leonora Shala	Zv. koordinatorë	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	leonora.shala@rks-gov.net
24	Agim Bytyqi	Koordinator	Jeta dhe puna	agim.a.bytyqi@rks-gov.net agimbytyqigov@gmail.com
25	Ryve Prekorogja	Zv. Koordinatorë	Jeta dhe puna	ryve.prekorogja@rs-gov.net
26	Shyhrete Reçica	Koordinatorë	Kurrikula me zgjedhje	shyhrete.reqica@rks-gov.net
27	Lirije Gosalci	Zv. Koordinatorë	Kurrikula me zgjedhje	lirije.gosalci@rks-gov.net

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

373.5.016

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës / Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (e rishikuar). – Prishtinë : MASHT, 2016. – 77 f. : ilustr. ; 28 cm.

Bibliografia : f. 69-74

ISBN 978-9951-16-104-6

